

WWII-MONUMENTSEE

VLERËSIMI I MONUMENTEVE TË PAS-LUFTËS SË DYTË BOTËRORE NË EVROPËN JUGLINDORE ME QËLLIM TË ZHVILLIMIT TË NJË PRODUKTI TË RI RAJONAL TURISTIK/RRUGË KULTURORE



Vlerësimi i monumenteve të pas-Luftës së Dytë Botërore në Kosovë me qëllim të zhvillimit të një produkti të ri rajonal turistik/rrugë kulturore në Evropën Juglindore



“Vlerësimi i monumenteve të pas-Luftës së Dytë Botërore në Kosovë me qëllim të zhvillimit të një produkti të ri rajonal turistik/rrugë kulturore në Evropën Juglindore” u realizua në kuadër të projektit “WWII-MONUMENTSEE – Vlerësimi i monumenteve të kushtuara Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për të zhvilluar prodhimin e ri turistik rajonal/rutën kulturore”.

“WWII-MONUMENTSEE – Vlerësimi i monumenteve kushtuar Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për të zhvilluar prodhimin e ri turistik rajonal/rutën kulturore” që u zbatua nga EXPEDITIO është financuar me mjete të siguruara përmes Projektit për Zhvillimin dhe Promovimin e Turizmit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (Regional Cooperation Council – RCC). Ky projekt i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal financohet nga Bashkimi Evropian, dhe zbatimi i tij synon që të kontribuojë në rritjen dhe konkurrueshmërinë e gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor përmes mbështetjes së zhvillimit dhe promovimit të ofertës së përbashkët rajonale kulturore dhe aventuriste në turizëm. Ky vlerësim është një nga rezultatet e projektit “WWII-MONUMENTSEE – Vlerësimi i monumenteve kushtuar Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për të zhvilluar prodhimin e ri turistik rajonal/rutën kulturore”.

Redaktorët/Botuesit:

EXPEDITIO



Autori i “Vlerësimi i monumenteve të pas-Luftës së Dytë Botërore në Kosovë me qëllim të zhvillimit të një produkti të ri rajonal turistik/rrugë kulturore në Evropën Juglindore”

Fjollë Caka



Provided by the RCC Tourism Development and Promotion Project's Grant Programme



The Project is funded by the European Union

Përmbajtje

Hyrje.....	1
Përmbledhje e shkurtër.....	5
Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të monumenteve të luftës së dytë botërore në Kosovë.....	7
Lista e gjerë e monumenteve.....	13
Përshkrimi i rrugëve potenciale të monumenteve të luftës së dytë botërore	17
Shembujt e analizës së detajuar të monumenteve të përzgjedhura	24
Monumenti për Heronjtë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare	25
Monumenti për Minatorët e Rënë, Mitrovicë Veriore	42

Hyrje

Projekti “WWII-MONUMENTSEE - Vlerësimi i monumenteve kushtuar Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për të zhvilluar prodhimin e ri turistik rajonal/rutën kulturore” (më tutje në tekst WWII-MONUMENTSEE) që u zbatua nga EXPEDITIO është financuar me mjete të siguruara përmes Projektit për Zhvillimin dhe Promovimin e Turizmit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (Regional Cooperation Council – RCC). Ky projekt i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal financohet nga Bashkimi Evropian, dhe zbatimi i tij synon që të kontribuojë në rritjen dhe konkurrueshmërinë e gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor përmes mbështetjes së zhvillimit dhe promovimit të ofertës së përbashkët rajonale kulturore dhe aventuriste në turizëm. Ky vlerësim është një nga rezultatet e projektit WWII-MONUMENTSEE.

Projekti WWII-MONUMENTSEE është zbatuar gjatë periudhës nëntor 2018 – qershor 2019.

Zona e zbatimit të projektit: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kosova*, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut.

Monumentet kushtuar Luftës së Dytë Botërore në zonën e Evropës Juglindore paraqesin potencial të konsiderueshëm për zhvillim të një rute rajonale kulturore turistike. Këto monumente, shumica e të cilave është ndërtuar gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore në gjithë territorin e ish-Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, pikësepari përfaqësojnë memoriale të luftës antifashiste, por ato janë edhe më shumë se aq, e disa nga to kanë vlera të jashtëzakonshme artistike. Pas ndryshimeve që kanë ndodhur gjatë viteve të 90-ta të shekullit XX në zonën e Evropës Juglindore vjen deri tek shpërfillja e këtyre monumenteve, gjë që ka çuar deri tek lënia pas dore e tyre për shkak të mos mirëmbajtjes, dhe në disa raste edhe deri tek shkatërrimi ose rrënimi i plotë i tyre. Interesimi i përtëritur për këto monumente filloi në fillim të shekullit XXI, që nga viti 2006, i stimuluar nga artistët dhe studiuesit e huaj, e gjithashtu edhe nga ata të rajonit të Evropës Juglindore. Për më tepër, rëndësia e monumenteve të pas-Luftës së Dytë Botërore përsëri ka filluar të rizuohet edhe në dritën e turizmit. Megjithatë, të gjitha këto nisma dhe aktivitete janë sporadike, shpesh vijnë nga vende të tjera prej atyre ku ndodhen monumentet, dhe nuk janë të sinkronizuara, ashtu që këto monumente nuk ofrohen si një produkt turistik i veçantë, as në kuadër të shteteve individuale e as në kuadër të rajonit të Evropës Juglindore. Gjithashtu, nuk ka të dhëna rreth monumenteve të grumbulluara në një vend, por as analiza të detajuara të vlerave të tyre, gjendjes, si dhe potencialit të tyre për zhvillimin e rutave turistike.

*Kjo shenjë nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të sigurisë së Kombeve të Bashkuara dhe me Mendimin e Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë mbi deklaratën mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Objektivi specifik i projektit WWII-MONUMENTSEE është zbatimi i fazës fillestare të zhvillimit të prodhimit të ri rajonal turistik/rutës kulturore – monumentet kushtuar Luftës së Dytë Botërore – në zonën e Evropës Juglindore, përmes hartimit të vlerësimit. **Objektivat e përgjithshme** të projektit janë: zhvillimi i produktit të ri rajonal turistik/rutës kulturore – monumentet e kushtuara Luftës së Dytë Botërore – në zonën e Evropës Juglindore; avancimi (i punësimit dhe i qëndrueshmërisë) së turizmit rajonal në zonën e Evropës Juglindore përmes zhvillimit të produktit të ri rajonal turistik/rutës kulturore; kontributi tek rritja e ekonomike e rajonit të Evropës Juglindore përmes fuqizimit të turizmit rajonal dhe rutave kulturore.

Aktivitetet që janë realizuar gjatë projektit WWII-MONUMENTSEE kanë përfshirë: formimin e ekipit rajonal të ekspertëve dhe përkufizimin e konceptit dhe metodologjisë së punës; studimi dhe mbledhja e të dhënave nga 6 ekonomitë e Evropës Juglindore dhe hartimi i 6 “Vlerësimeve të monumenteve kushtuar Luftës së Dytë Botërore për formimin e produktit të ri rajonal turistik/rutës kulturore në zonën e Evropës Juglindore” individuale nga studiuesit e përzgjedhur; organizimi i punëtorisë rajonale të ekspertëve; hartimi i “Vlerësimit të monumenteve kushtuar Luftës së Dytë Botërore në Evropën Juglindore për formimin e prodhimit të ri turistik rajonal/rutës kulturore në Evropën Juglindore” dhe shpërndarja e rezultateve të projektit të gjithë palëve të interesuara.

Hartimi i 6 “Vlerësimeve të monumenteve kushtuar Luftës së Dytë Botërore për formimin e produktit të ri rajonal turistik/rutës kulturore në zonën e Evropës Juglindore” individuale ka përfshirë këto aktivitete dhe segmente:

- **Shqyrtimi i gjendjes së përgjithshme të trashëgimisë së monumenteve të Luftës së Dytë Botërore** që synoi ofrimin e një pasqyre të përgjithshme mbi trajtimin e këtij segmenti të trashëgimisë kulturore në 6 ekonomi, duke përfshirë: kornizën ligjore e cila e rregullon mbrojtjen, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore; institucionet/aktorët kryesorë përgjegjës për mbrojtjen, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe promovimin e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore; nismat e deritanishme (projektet artistike, studimet, promovimet, aktivizmin...); një përmbledhje e palëve të interesuara/hisedarëve dhe një pasqyre e gjendjes së përgjithshme të monumenteve të Luftës së Dytë Botërore: mbrojtja, mirëmbajtja, përdorimi, menaxhimi dhe valorizimi turistik i tyre.
- **Analiza e listës së zgjeruar të monumenteve** është bërë në bazë të listave zyrtare të monumenteve të mbrojtura të Luftës së Dytë Botërore në ekonomitë e caktuara si dhe në bazë të Listës së Siteve të Propozuara për rutat e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore që është dorëzuar nga Këshilli Rajonal për Bashkëpunim, dhe që ka

përfshirë 40 monumente tashmë të përzgjedhura që do të duhej të përfshihen gjithsesi.¹ Analiza e monumenteve është bërë në bazë të kriterëve të përcaktuara².

¹ Lista e dorëzuar nga RCC ka përfshirë 40 monumente:

- *Shqipëria*: Shkodër, Kamëz, Nënë Tereza (Tiranë), Pezë e Vogël, Bërzhitë, Elbasan, Pishkash
- *Bosnje-Hercegovina*: Parku memorial Vraca (Sarajevo), Monumenti Vogošća, Muzeu memorial i betejës së Neretves (Jablanica), Varrezat e partizaneve në Mostar, Monumenti Sutjeska (Tjentište), Zenica, Novi Travnik, Jajce, Sanski Most, Kozara (afër Prijedorit), Banja Luka
- *Kosova*: Prishtinë (qendër), Monumenti në Brezovicë, Mitrovica Veriore, Varrezat e Martirëve Partizanë në Matiçan të Prishtinës
- *Mali i Zi*: Siti memorial Dola, Monumenti në Nikšić, Monumenti në Barutanë (Podgoricë), Muzeu memorial në Kolašin, Monumenti në Berane
- *Serbi*: Varrezat hebrenj (Beograd), Parku memorial Jajinci, Monumenti Kosmaj, Siti memorial Čačak, Siti memorial Kadinjača (afër Užices), Parku memorial Bubanj (Nish), Parku memorial Šumarice (Kragujevac), Monumenti i revolucionit (Leskovac)
- *Republika e Maqedonisë së Veriut*: Monumenti i tërmetit të Shkupit, Eshtërorja Kičevo, Makedonium (Krushevo), Monumenti në Prilep, Eshtërorja Veles

² Kriteret ishin këto:

- **CILËSITË VIZUALE DHE ESTETIKE**: forma abstrakte; format që i kundërvihen konventës së monumenteve tradicionale; format që fshehin domethënien simbolike më të thellë dhe/ose vlerën universale pas formës së vetë abstrakte; që janë krijuar nga artistët e famshëm, të njohur ose të përsosur të asaj epoke
- **RËNDËSIA HISTORIKE DHE KULTURORE**: monumentet që flasin për ngjarje universale të përballimit të vështirësive dhe mposhtjes së armikut; të fokusuar tek niveli njerëzor/fitorja ose tragjedia e civileve; përshkruajnë ngjarjet interesante që janë pak të njohura jashtë zonës së caktuar
- **BUKURIA NATYRORE**: të jepet përparësi monumenteve që ndodhen në ambientin jashtëzakonisht të bukur natyror; të jepet përparësi monumenteve që ndodhen në afërsi të parqeve kombëtare, lumenjve piktoreske, etj.; të jepet përparësi monumenteve që ndodhen në vende të qeta larg nga turmat tjera turistike
- **TURIZMI**: promovojnë turizmin në zona jo mjaft të zhvilluara
- **GJENDJA**: në zona ku nuk ka tensione ose dhunë politike/fetare/etnike; në zona të cilat nuk janë të rrezikuara nga minat dhe mjetet tjera të rrezikshme; zonat që janë relativisht të paprekura dhe përmes të cilave nuk është rrezik të kalohet; monumentet që janë në gjendje racionalisht të rregullt dhe të ruajtur; që nuk janë shumë të shkatërruara ose të vandalizuara
- **QASSHMËRIA**: ndodhen në afërsi racionale të rrugëve parësore ose autostradave, ndodhen në afërsi racionale të shërbimeve turistike (akomodimi, ushqimi, karburanti, etj.); mund t'i gjejnë turistët të cilët nuk e njohin zonën; plotësisht të qasshëm gjatë gati gjithë vitit, përveç në raste të kushteve ekstreme të motit.

- **Propozimi i rutave potenciale** për çdo ekonomi është dhënë në bazë të listës së gjerë të monumenteve. Janë identifikuar mundësitë për nivele të ndryshme të rutave: ruta/t rajonale, rutat në kuadër të shteteve, rutat lokale. Gjithashtu, janë shqyrtuar temat e ndryshme, midis të cilave: vlera artistike, autori/-ët, personat e njohur, madhësia, filmimi, mundësitë për alpinizëm, antifashizmi etj. Përveç këtyre, janë shqyrtuar edhe mundësitë për përfshirjen e monumenteve në rutat tashmë ekzistuese ose në ofertën turistike të zonës.
- **Analiza e detajuar e monumenteve të përzgjedhura** është bërë në bazë të analizave të bëra për 10-12 monumente të secilës ekonomi, të cilat ndodhshin në Listën e dorëzuar nga RCC-ja, si dhe në listën e zgjeruar të monumenteve të përzgjedhura nga studiuesit. Analiza e detajuar është bërë në bazë të formularit i cili është përgatitur nga ekipi i ekspertëve rajonalë.
- **Lista e literaturës dhe shtojcat** që kanë shoqëruar secilin vlerësimi, përfshirë ndër të tjera edhe: listën zyrtare të monumenteve të mbrojtura të Luftës së Dytë Botërore; listën e palëve të interesuara/hisedarëve; si dhe materialin shtesë të rëndësishëm për shqyrtim të gjendjes së përgjithshme të trashëgimisë së monumenteve të Luftës së Dytë Botërore.

Në bazë të Vlerësimeve individuale në 6 ekonomitë është punuar **“Vlerësimi i monumenteve kushtuar Luftës së Dytë Botërore për formimin e prodhimit të ri rajonal turistik/rutës kulturore në Evropën Juglindore”** i përbashkët rajonal.

“Vlerësimi i monumenteve të pas-Luftës së Dytë Botërore në Kosovë me qëllim të zhvillimit të një produkti të ri rajonal turistik/rrugë kulturore në Evropën Juglindore” është një nga 6 vlerësime individuale të zbatuara në kuadër të projektit. Autorja e këtij vlerësimi është Fjollë Caka.

Ky dokument përmban një **ekstrakt nga Vlerësimi i monumenteve kushtuar Luftës së Dytë Botërore në Kosovë** që përfshin të dhënat kyçe, analizat dhe propozimet, ndërsa i tërë materiali me dokumentacionin e bashkëlidhur i është dorëzuar RCC-së.

Përmbledhje e shkurtër

Monumente që përkujtojnë Luftën e Dytë Botërore janë ndërtuar edhe nëpër Kosovë, e cila gjatë kohës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ishte një krahinë autonome. Përveç nderimit të luftëtarëve dhe dëshmorëve antifashistë, këto monumente promovuan respektin, barazinë dhe identitetin e përbashkët midis të gjitha kombeve që jetonin në RSFJ. Në Kosovë, këto monumente u ndërtuan në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Kamenicë, si dhe në qytete të tjera ose në vendet ku u zhvilluan luftimet. Vetë monumentet, të mbështetura nga tubimet vjetore të organizuara nga shteti, kishin për qëllim të përkujtonin heroizmin dhe sakrificën e dëshmorëve dhe të festonin fitoren e revolucionit (Maliqi, 2014, fq. 13). Monumentet gjithashtu synonin të promovonin respektin, 'bashkësinë', barazinë dhe identitetin e përbashkët midis të gjitha kombeve që jetonin në RSFJ (Maliqi, 2014, fq.13).

Sidoqoftë, këto monumente nuk ishin aq mirë të pranuar nga qytetarët në Kosovë, pasi barazia dhe identiteti i përbashkët nuk ishin diçka që shqiptarët nga Kosova i ndanë me kombësitë e tjera në RSFJ. Ata nuk gëzonin të njëjtat të drejta si nacionalitetet tjera në RSF të Jugosllavisë. Rrjedhimisht, pas rënies së RSFJ-së, monumentet e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë humbën rëndësinë e tyre; pra, u braktisën, u dëmtuan ose u shkatërruan.

Ato që kanë mbijetuar deri më sot janë të vandalizuara; shumicës prej tyre u janë zhveshur pllakat ku ndodheshin informacionet përkatëse, u janë hequr fletët e bakrit ose elementet e tjera, si dhe u janë shtuar mbishkrime/grafite (shpesh me përmbajtje nënçmuese) (forumZFD, 2014, fq. 13). Ato janë braktisur (ideologjikisht dhe fizikisht) nga qytetarët e Kosovës (të të dy etnive, si nga ajo shqiptare ashtu edhe nga ajo dhe serbe) dhe janë lënë pas dore nga shteti i Kosovës. Aktualisht, shumica e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë janë në gjendje të keqe, nuk kanë status të mbrojtjes, si dhe nuk kanë mirëmbajtje e kujdes të duhur. Vetëm gjashtë monumente të Luftës së Dytë Botërore për përkujtimin e Lëvizjes apo Ushtrisë Nacionalçlirimtare (LNÇ) janë shtuar në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të pPërkohshme të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) (e cila ofron një periudhë mbrojtjeje njëvjeçare). Nga këto gjashtë monumente, një është shkatërruar plotësisht dhe një tjetër është vendosur në një pronë private. Lokacioni i një monumenti tjetër nuk është përditësuar, siç është rasti i monumentit në Rakanoc (Rakanovac), i cili është i listuar në Komunën e Ferizajit, por aktualisht ndodhet në Komunën e Shtërpçës (që është themeluar gjatë procesit të decentralizimit në vitin 2013). Shumë monumente të tjera të rëndësishme që i përkasin Luftës së Dytë Botërore, të cilat përkujtojnë vetë luftën apo paraqesin historinë e qyteteve të Kosovës, mbeten jashtë listës.

Megjithëse duket se aktualisht janë 11 monumente të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, studiuesja ka përfshirë vetëm 10 monumente (duke shpërfillur bunkerin e vendosur në një pronë private) në listën e zgjeruar të monumenteve të Luftës së Dytë Botërore. Shumica e monumenteve (3 prej tyre) ndodhen në Prishtinë, kryeqytetin e Kosovës, ndërsa të tjerat ndodhen në komuna të tjera, duke përfshirë Shtërpçën (2 monumente), Mitrovicën Veriore (1), Fushë Kosovën (1), Gjakovën (1), Shtimen (1) dhe Vitinë (1). Prej tyre gjashtë monumente janë të analizuara hollësisht, duke përfshirë Monumentin për Minatorët e Rënë në Mitrovicën Veriore, Monumentin për Aradhën Partizane të Malit të Sharrit dhe

Monumentin e Heronjve të LNÇ, Varrezat e Martirëve Partizanë, si dhe Monumentin e Boros dhe Ramizit në Prishtinë. Të gjitha këto monumente kanë vlera të rëndësishme historike dhe artistike. Shumë prej tyre ishin pikë referimi të qyteteve ku ndodhen dhe janë shfaqur në shumë kartolina Jugosllave. Shembuj të tillë përfshijnë Monumentin e Minatorëve të Rënë në Mitrovicën Veriore (projektuar nga Bogdan Bogdanoviq) dhe Monumentin e Heronjve të LNÇ në Prishtinë (projektuar nga Miodrag Zhivkovic).

Monumentet e Luftës së Dytë Botërore që ende qëndrojnë në Kosovë paraqesin një potencial të konsiderueshëm për hulumtime akademike (në lidhje me historizmin, stilet artistike, përfaqësimin vizual, simbolizmin dhe vlerat shoqërore), për rivitalizimin hapësinor (përmirësimi i qasjes dhe i infrastrukturës, rinovimi i monumenteve, mirëmbajtja e peizazheve, shtimi i të infografikës), si dhe për zhvillimin ekonomik (përmes paketave turistike). Rritja e ndërgjegjësimit për këto monumente dhe memoriale, si tek të qytetarët lokalë ashtu edhe tek vizitorët ndërkombëtarë, mund të iniciohet nëpërmjet një hulumtimi më të plotë arkivor dhe me studime mbi monumentet, përmes krijimit të një baze të të dhënave mbi monumentet që qëndrojnë dhe për ato të shkatërruara, si dhe me informacione shtesë (pllaka përshkruese) përreth monumenteve, si dhe me më shumë ngjarje diskutuese dhe vizita studimore.

Duke u bazuar në vlerësimin dhe dokumentimin e këtyre monumenteve të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, ky hulumtim propozon tri shtigje/rrugë të mundshme turistike për t'i vizituar këto monumente, të bazuara në afërsinë gjeografike ose përfaqësimin artistik të tyre.

Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të monumenteve të luftës së dytë botërore në Kosovë

Që nga viti 1945 deri në fund të viteve 1980, disa monumente përkujtimore të Luftës së Dytë Botërore janë ndërtuar edhe nëpër Kosovë, e cila gjatë kohës së Republikës Socialiste Federative (RSF) të Jugosllavisë ishte një krahinë autonome. Lapidarët, statujat, varrezat e dëshmorëve dhe parqet përkujtimore u ndërtuan në pothuajse çdo komunë të Kosovës, qoftë në qendrat e qytetit apo në fushëbeteja (Maliqi, 2014, fq. 13). Ato përkujtuuan ngjarjet (betejat) e brigadave partizane (siç është monumenti i Minatorëve në Mitrovicë) ose nderuan heronjtë/dëshmorët e shquar të luftës antifashiste (si monumentet e Boro Vukmirovicqit dhe Ramiz Sadikut në Landovicë dhe në Prishtinë).

Vetë monumentet, të mbështetur nga tubimet vjetore të organizuara nga shteti, kishin për qëllim të përkujtonin heroizmin dhe sakrificën e dëshmorëve dhe të festonin fitoren e revolucionit (Maliqi, 2014, fq. 13). Ato gjithashtu synonin promovimin e respektit, "bashkësisë", barazisë dhe identitetit të përbashkët të të gjitha kombeve që jetonin në RSFJ (Maliqi, 2014, fq. 13). Vlerat e tilla shpesh u përcollën nëpërmjet dizajnit dhe simbolizmit socialist dhe futuristik të monumenteve (Burmund & Pfeifer, 2010, fq. 3). Prandaj, dizajni i monumenteve të Luftës së Dytë Botërore i'u besua artistëve, skulptorëve dhe arkitektëve të mirënjohur jugosllavë, siç ishin Bogdan Bogdanoviq (monumenti i Minatorëve në Mitrovicën Veriore) dhe Miodrag Zhivkoviq (monumentet në Prishtinë dhe në Fushë Kosovë) (Burghardt & Kirn, 2012, fq. 85).

Sidoqoftë, këto monumente nuk ishin aq mirë të pranuar nga qytetarët e Kosovës, pasi barazia dhe identiteti i përbashkët nuk ishin diçka që Shqiptarët e Kosovës i ndanë me kombësitë tjera në RSFJ. Ata nuk gëzonin të drejtat e njëjta sikur nacionalitetet tjera në RSF të Jugosllavisë. Prandaj, pas rënies së RSF të Jugosllavisë dhe luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, monumentet e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë humbën rëndësinë e vetë (Caka, 2016, fq. 18). Në vitin 1999 ekzistonte një valë e largimit dhe të shkatërrimit të monumenteve të ndërtuara gjatë periudhës jugosllave, si dhe nga Slobodan Millosheviq (Burmund & Pfeifer, 2010, fq. 43). Shumë prej tyre u dëmtuan rëndë dhe u prishën (p.sh. ato në Pejë ose Lipjan) ose u shkatërruan plotësisht (siç janë ato në Gjilan, Ferizaj, Landovicë, Rahovec dhe Kamenicë).



Figura 1. Monumentet e shkatërruara në Gjiilan (majtas) dhe Landovicë (djathtas). Burimi: Spomenik Database.



Figura 1. Monument i shkatërruar në Pejë. Burimi: Marko Krojac.

Ato që kanë mbijetuar deri më sot janë të vandalizuara; shumicës prej tyre u janë zhveshur pllakat ku ndodheshin informacionet përkatëse, u janë hequr fletët e bakrit ose elementet e tjera, si dhe u janë shtuar mbishkrime/grafite (shpesh me përmbajtje nënçmuese) (forumZFD, 2014, fq. 13). Ato janë braktisur (ideologjikisht dhe fizikisht) nga qytetarët e Kosovës (të të dy etnive, si nga ajo shqiptare ashtu edhe nga ajo dhe serbe) dhe janë lënë pas dore nga shteti i Kosovës. "Dikur një mësim i rëndësishëm i filozofisë dhe historisë socialiste dhe ndërtimit të kombit, tani vetëm një tekst i fshirë, një drejtim i harruar. Vetëm format e tij të ngurta i përkujtojnë shikuesit diçka të humbur dhe një apirtatë të zbehtë (forumZFD, 2014, fq. 13)". Aktualisht shumica e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore nuk konsiderohen zyrtarisht si një trashëgimi e përbashkët me vlera historike ose artistike; pra, nuk mbrohen ligjërisht, por as nuk restaurohen dhe nuk menaxhohen.

Trashëgimia kulturore në Republikën e Kosovës mbrohet dhe menaxhohet në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-088 mbi Trashëgiminë Kulturore, miratuar në vitin 2006 nga Ministria

e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Në kompetenca të kësaj Ministrie janë çështjet arkeologjike, arkitekturale, natyrore, kulturore, ato të peizazhit, të trashëgimisë së luajtshme dhe asaj jo materiale. Agjencia përgjegjëse për mbrojtje dhe ruajtje, hulumtime dhe publikime, si dhe për promovimin e trashëgimisë së Kosovës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor është Departamenti i Trashëgimisë Kulturore pranë MKRS.

Ministria harton dy lista kryesore për mbrojtjen dhe menaxhimin e pasurive të saj, të cilat përfshijnë Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përhershme dhe Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme. Nuk ka listë zyrtare apo bazë të të dhënave për monumentet e Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë, disa janë shtuar në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme të MKRS (e cila përcakton një periudhë mbrojtjeje prej një viti)³. Lista për harkun kohor 2018-2019 përbëhet nga 1595 asete arkeologjike, arkitekturale, natyrore, kulturore, atyre që i takojnë peizazhit, si dhe objekteve të luajtshme dhe trashëgimisë jo materiale (MKRS, 2018). Prej tyre, 921 (57.8%) të aseteve i takojnë trashëgimisë arkitekturore, që përbëhet nga monumentet⁴ dhe komplekset. Vetëm gjashtë nga të gjitha monumentet e listuara përkujtojnë Ushtrinë ose Lëvizjen Nacionalçlirimtare (LNÇ), që është më pak se 1% e të gjithë monumenteve të listuara.

Nga këto gjashtë monumente, një është shkatërruar plotësisht (shatërvani i LNÇ në Zborc, në Shtime) dhe një tjetër është vendosur në një pronë private. Lokacioni i një monumenti tjetër nuk është përditësuar, siç është rasti i monumentit në Rakanoc (Rakanovac), i cili është i listuar në Komunën e Ferizajt, por aktualisht ndodhet në Komunën e Shtërpçës (që është themeluar gjatë procesit të decentralizimit në vitin 2013). Monumente të tjera janë Varrezat e Martirëve Partizanë në Prishtinë, Eshtërorja e Luftëtarëve të rënë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Gjakovë⁵ dhe Monumenti i LNÇ-së në Viti.⁶ Shumë

³ Propozimet për përfshirjen e aseteve të ndryshme në një nga listat mund të dorëzohen nga institucionet kompetente, personat juridikë ose fizikë. Propozimet vlerësohen nga institucionet kompetente (p.sh. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore, Institucioni për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore) dhe miratohen nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

⁴ Monumente konsiderohen ndërtimet/konstruksionet dhe strukturat (duke përfshirë elementet e luajtshme që janë pjesë e tyre) e dalluara për nga vlerat e tyre historike, arkeologjike, artistike dhe shkencore, me interes shoqëror ose teknik (Ligji Nr. 02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, 2006, fq. 3).

⁵ Emri i Eshtërores së Luftëtarëve të Rënë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në Gjakovë është ndërruar në Monumentin e Fadil Hoxhës, në vitin 2018. Kompleksi është në gjendje të keqe dhe nuk është i mirëmbajtur në mënyrë të duhur. Ka qenë i mbyllur për disa vite, ndërsa tani ka disa përpjekje për rinovimin e tij. Meqenëse nuk ka shumë informata rreth monumentit në literaturë dhe në internet, si dhe hulumtuesja nuk mundi të ketë qasje në të, monument është shpërfillur nga analizat e mëtejshme të këtij projekti.

⁶ Monumenti i LNÇ në Ramjan (Viti), Çezma Përkujtimore e LNÇ-së në Zborc (Shtime) dhe Monumenti i LNÇ-së në Rakanoc (Shtërpçë) nuk janë analizuar në detaje e as nuk janë përfshirë në rrugët e sugjeruara të këtij projekti, meqë nuk ka shumë informata të disponueshme rreth tyre, monumentet origjinale janë shkatërruar plotësisht ose janë rindërtuar, si dhe ato ekzistuese nuk përfaqësojnë vlera autentike.

monumente të tjera të rëndësishme që i përkasin Luftës së Dytë Botërore, të cilat përkujtojnë vetë luftën apo paraqesin historinë e qyteteve të Kosovës, mbeten jashtë listës.

Prandaj, në këtë projekt, disa prej monumenteve të Luftës së Dytë Botërore që ende qëndrojnë në Kosovë janë identifikuar, lokalizuar, analizuar dhe dokumentuar. Përveç gjashtë monumenteve të përfshira në listën e trashëgimisë kulturore të MKRS-së për mbrojtjen e përkohshme, hulumtuesja ka identifikuar pesë monumente shtesë, shumica e të cilave janë në gjendje të keqe në aspektin e mirëmbajtjes, por ende qëndrojnë fizikisht. Nga këto monumente, ato që dallohen me domethënie në kuptimin e vlerave të tyre historike, sociale dhe artistike janë Monumenti i Minatorëve të Rënë/Tempulli i Revolucionit në Mitrovicën Veriore, Monumenti i Heronjve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare/Monumenti i Revolucionit në Prishtinë, Monumenti i Aradhës Partizane të Malit të Sharrit në Shtërpçë dhe Monumenti i Boro Vukmiroviqit dhe Ramiz Sadikut në Prishtinë. Ekziston edhe një monument tjetër i Luftës së Dytë Botërore i vendosur në Sheshin e Lirisë në Fushë Kosovë që ende qëndron⁷.

Asnjë nga monumentet e listuara (por as nga ato të pa listuara) nuk u kushtohet kujdes në aspektin e rinovimit, mirëmbajtjes dhe të menaxhimit.⁸ Sfida të tjera përfshijnë mungesën e interesit nga institucionet dhe publiku i gjerë për t'i mbajtur (mirëmbajtur ose restauruar) ato, ndarja e paqartë e roleve dhe përgjegjësive të agjencive për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve,⁹ mungesa e njohurive rreth monumenteve nga vetë popullata e gjerë (posaçërisht nga të rinjtë), mungesa e informacionit të besueshëm (p.sh. emri i monumentit, projektuesi, viti i ndërtimit, viti i mbrojtjes etj.), mungesa e menaxhimit, si dhe tendenca për shkatërrimin e tyre (dhe zëvendësimin me monumente të tjera, kryesisht ato që përkujtojnë luftën e fundit që u zhvillua në Kosovë, 1998-1999) (Caka, 2016, fq. 22).

⁷ Nuk ka asnjë informatë rreth monumentin, asnjë emër i tij apo dedikim se kujt i është kushtuar nuk dihet; megjithatë, duke u bazuar në një gdhendje të fshehur dhe stilin e tij, duket se monumenti është projektuar nga skulptori i njohur Miodrag Zhivkoviq. Një nga monumentet në këtë lokacion ka figura bronzi me tipare të gruas, prandaj është unik në krahasim me monumentet e tjera të mbetura. Meqë lokacioni i monumentit është afër Prishtinës, studiuesja e ka shtuar këtë monument të harruar në rrugët e sugjeruara, duke shpresuar se ekspozimi ndaj tij, kureshtja dhe pyetjet pa përgjigje do të nxjerrin në dritë më shumë informacione rreth monumentit.

⁸ Kosova e ka një Agjenci për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, e cila është përgjegjëse për projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e komplekseve memoriale, të cilat përcaktohen si "zona me interes të veçantë kombëtar dhe karakter historik" (AMKM, p.d.). Megjithatë, kjo agjenci nuk përfshinë monumentet dhe përmendoret e Luftës së Dytë Botërore. Ajo merret vetëm me çështjet e përmendoreve të kushtuara ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe luftës së fundit në Kosovë të viteve 1998-1999 (AMKM, p.d.).

⁹ Menaxhimi dhe mirëmbajtja (administrimi) e monumenteve nuk është përcaktuar qartë me Ligjin Nr. 02/L-088 mbi Trashëgiminë Kulturore. Megjithatë, MKRS ka vënë në diskutim Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-088 mbi Trashëgiminë Kulturore, i cili synon të racionalizojë numrin e agjencive (dhe kompetencave të tyre), për të kombinuar politikë-bërjen dhe funksionet zbatuese, dhe për të mbështetur zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm.

Sidoqoftë, monumentet e mbetura të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë paraqesin një potencial të konsiderueshëm për hulumtime akademike (në lidhje me historizmin, stilet artistike, përfaqësimin vizual, simbolizmin dhe vlerat shoqërore), për rivitalizimin hapësinor (përmirësimi i qasjes dhe i infrastrukturës, rinovimi i monumenteve, mirëmbajtja e peizazheve, shtimi i të infografikës), si dhe për zhvillimin ekonomik (përmes paketave turistike). Rritja e ndërgjegjësimit për këto monumente dhe memoriale, si tek të qytetarët lokalë ashtu edhe tek vizitorët ndërkombëtarë, mund të iniciohet nëpërmjet një hulumtimi më të plotë arkivor dhe me studime mbi monumentet, përmes krijimit të një baze të të dhënave mbi monumentet që qëndrojnë dhe për ato të shkatërruara, si dhe me informacione shtesë (pllakat përshkruese) përreth monumenteve, si dhe me më shumë ngjarje diskutuese dhe vizita studimore.

Disa nga palët e interesuara (hisedarët) për trajtimin e këtyre mundësive rreth monumenteve të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë përfshijnë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Qendrat Rajonale për Trashëgiminë Kulturore), komunat (vetëqeverisjet lokale), OJQ-të (që merren me trashëgiminë kulturore, turizmin, zhvillimin ekonomik), bizneset (agjencitë turistike, byrotë e arkitekturës, agjencitë e marketingut), ekspertët (arkitektë, artistë, historianë, sociologë, ekonomistë, planifikues urbanë etj.), akademia dhe komuniteti i gjerë. Për një listë të plotë të palëve të interesuara, referohuni tek *02-Palët e interesuara në Kosovë*.

Organizata më aktive në mbrojtjen e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë është Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës - OVLANÇ. Ajo dënon ashpër shkatërrimin dhe mungesën e mirëmbajtjes së monumenteve të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, duke deklaruar se këto veprime pakësojnë kontributin e rreth 6.200 dëshmorëve (nga 53.000 vendorë) të cilët luftuan kundër pushtimit fashist gjatë Luftës së Dytë Botërore (OVLANÇ, 2019). Sipas OVLANÇ-it, këto monumente dhe memoriale përkujtojnë heroizmin e luftëtarëve vendas dhe festojnë fitoren ndaj fashizmit, prandaj ato duhet të mbrohen dhe të ruhen në mënyrë të duhur. Rrjedhimisht, organizata mbështet nismat për mbrojtjen dhe rinovimin e monumenteve dhe përkujtimeve të Luftës së Dytë Botërore, angazhohet në aktivitetet përkujtime të ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore, si dhe kultivon dhe promovon vlerat dhe idealet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Disa nga aktivitetet përkujtime përfshijnë kremtimin 75-vjetorit të çlirimit nga fashizmi, krijimit të aradhës së parë shqiptare "Zenel Hajdini", kremtimin e ditëve të fitores dhe çlirimit nëpër qytete të ndryshme të Kosovës, etj.



Organizata të tjera të kësaj fushe që veprojnë në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit për monumentet e Luftës së Dytë Botërore dhe përfaqësimin e tyre janë forumZFD, Alter Habitus - Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë, Programi Universitar për Studime dhe Hulumtime Gjinore, Stacion - Qendra për Art Bashkëkohor në Prishtinë, Fondacioni Kosovar i Arkitekturës dhe Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut. Shumë artistë dhe arkitektë të tjerë, por edhe shumë media liberale (përfshirë Kosovo 2.0 dhe KultPlus) mbështesin monumentet si mbetje/përkujtuese të një periudhe të rëndësishme të Kosovës, me vlera të rëndësishme artistike dhe sociale.

Burimet:

1. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale (AMKM). (n.d.). *Agjencia – Statusi i Agjencisë dhe Kompetencat e Agjencisë*. Link: <https://amkkm.rks-gov.net/en/agjencia/>
2. Burghardt R. & Kirn G. (2012). *Yugoslavian Partisan Memorials: Hybrid Memorial Architecture and Objects of Revolutionary Aesthetics*.
3. Burmund, D. & Pfeifer, Ch. (2014). *MONUMENT: The changing face of remembrance*. forumZFD & CRDP.
4. Caka, F. (2016). *Monumentet e socializmit në Prishtinë – Rast studimi ish-sheshi “Vëllazërim-Bashkim”*. Punim diplome për titullin Bachelor i Sociologjisë në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”
5. forumZFD Kosovo. (2014). *Handbook – Kosovo Memory Walk*. Memory Mapping Kosovo: Contested Memories. Prishtinë: forumZFD
6. Maliqi, Sh. (2014). *The war of symbols: Remembrance in Kosovo*. In: *MONUMENT: The changing face of remembrance* [Eds. Burmund, D. & Pfeifer, Ch.] forumZFD & CRDP.
7. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). (2018). *Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (10.10.2018 – 10.10.2019)*.
8. Organizata e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës – OVLANÇ. (2019). *Kryesia e OVLANÇ të Kosovës miratoi planin e aktiviteteve për vitin 2019*. Link: https://www.facebook.com/lancetekosoves/posts/747788608915928?_tn_ =K-R





Lista e gjerë e monumenteve

Ekonomia: KOSOVË



NR	EMRI	PROJEKTUESI	VITI I NDËRTIMIT	QYTETI/VENDI	NGJARJET QË SHËNON	KORDINATAT (Google Maps)	SHpjegimi i shkurtër	FOTOGRAFIA
1	Monumenti për Minatorët e Rënë APO Tempulli i Revolucionit	Bogdan Bogdanoviq	1973	Kodra e Minatorëve, Mitrovicë Veriore	Revolta e minatorëve më 30 korrik, 1941. Çlirimi i qytetit të Mitrovicës më 23 nëntor, 1944	42°53'45.3"N 20°51'36.4"E	Përkujton revoltën e minatorëve vendorë shqiptarë dhe serbë (Çeta e Minatorëve) kundër forcave gjermane.	
2	Varrezat e Martirëve Partizanë	Svetislav Liqina	1961	Kodra e Matëçanit në lagjen Velanija, Prishtinë	Revoltat e Çetës Partizane Lokale gjatë 1941-1944	42°39'31.8"N 21°10'31.8"E	Përfaqëson luftëtarë dhe civilë nga zona që u zhdukën gjatë luftës. MKRS, LTKMP, 2018. ¹⁰ Nr. rendor 1007, Nr. unik 3403.	

¹⁰ Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (LTKMP) për 2018-2019 e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)



WWII-MONUMENTSËE

3	Monumenti për Heronjë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare APO Monumenti i Revolucionit	Miodrag Zhivković	1961	Sheshi Adem Jashari (ish-Sheshi Vëllazërim Bashkim), Prishtinë	Çlirimi i Prishtinës më 19 nëntor, 1944	42°39'56.6"N 21°09'52.4"E	Përfaqëson të gjithë (shqiptarë, serbë dhe malazezë) luftëtarët e rënë dhe viktimat e luftës.	
4	Monumenti për Aradhën Partizane të Malit të Sharrit	Svetomir Arsiq Basara	1964	Brezovicë, Shtërpçë	Revoltat e Aradhës Partizane të Malit të Sharrit gjatë 1942-1943	42°13'12.0"N 20°59'49.5"E	Përkujton luftëtarët e Aradhës Partizane të Malit të Sharrit.	
5	Eshtërorja e Luftëtarëve të Rënë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare; Emërtuar Monumenti i Fadil Hoxhës në vitin 2018	Projekti kryesor i dizajnuar nga Skender Hasimja, ndërsa mozaiku nga Esat Valla, Masar Caka, dhe Ibrahim Ponosheci	1984	Çabrat, Gjakovë		42°22'48.4"N 20°25'16.7"E	Varrezat e luftëtarëve të rënë nga Gjakova dhe rrethina e saj gjatë LNÇ-së. <u>MKRS, LTKMP, 2018</u> . Nr. rendor 777, Nr. unik 871.	
6	Monumenti i Lëvizjes Nacionalçlirimtare (LNÇ)	I panjohur	1965	Ramjan, Viti	Themelimi i Çetës së Parë Partizane Shqiptare "Zenel Hajdini" më 17 shtator, 1942		Përkujton Çetën e Parë Partizane Shqiptare "Zenel Hajdini". Monumenti është shkatëruar në vitin 2003 dhe është rindërtuar nga Vahide Hoxha, e	

WWII-MONUMENTSËE

							veja e Fadil Hoxhës. <u>MKRS, LTKMP, 2018</u> . Nr. rendor 1258, Nr. unik 2745.	
7	Çezma Përkujtimore e Lëvizjes Nacionalçlirimtare (LNÇ)	I panjohur	1943	Zborc (Carralevë), Shtime	Lufta e 1943 në Carralevë; vdekja e Abdullah Shabanit (hero i Çetës Partizane "Zenel Hajdini")		Përkujton betejën e partizanëve në Carralevë. Çezma nuk ekziston më. Në afërsi ekziston një pllakë mermeri kushtuar Çetës Partizane "Zenel Hajdini" (dhe varri i Abdullah Shabanit). <u>MKRS, LTKMP, 2018</u> . Nr. rendor 1348, Nr. unik 3041; 2987.	
8	Monumenti i Boro Vukmiroviqit dhe Ramiz Sadikut	I panjohur	1961	Parki i Qytetit, Prishtinë	Vdekja e heronjëve partizanë Boro Vukmiroviqit (malazez) dhe Ramiz Sadikut (shqipëtar) në prill 1943	42°39'39.3"N 21°10'06.8"E	Përkujton miqësinë e dy partizanëve/ ushtarëve antifashistë, Boros dhe Ramizit, një simbol i Vëllazërimit Bashkimit.	

WWII-MONUMENTSËE

9	I panjohur	M(iodrag) Zhivković	1967 OSE 1987	Sheshi i Lirisë, Fushë Kosovë		42°38'07.1"N 21°04'56.3"E	Asnjë informatë nuk është gjetur në internet apo nga autoritetet. Në monumentin nga bronzi është gravuar "M. Zivkovic" në alfabetin cirilik dhe "67" ose "87" (nuk ka pamje të qartë).	
10	Monumenti i Lëvizjes Nacionalçlirimtare (LNÇ) APO Monumenti i Udhëtarëve	I panjohur	Shekulli XX	Rakanoc, Shtërpcë (jo në Ferizaj siç është shënuar në listën e MKRS-së)	Vdekja e 46 banorëve vendorë serbë, të vrarë nga forcat bullgare më 28 qershor, 1944	42°13'38.8"N 21°00'50.2"E	Dedikuar banorëve vendorë të vrarë nga forcat bullgare. Gjetet në Komunën e Shtërpcës, të themeluar pas procesit të decentralizimit në Kosovë. <u>MKRS, LTKMP, 2018</u> , Nr. rendor 1301, Nr. unik 2894.	

Përshkrimi i rrugëve potenciale të monumenteve të luftës së dytë botërore

Monumentet e Luftës së Dytë Botërore (LB II) në Kosovë mund të vizitohen dhe të eksplorojnë përmes tri rrugëve potenciale, të grupuara sipas temat e mëposhtme:

1. Monumentet e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë,
2. Monumentet e Luftës së Dytë Botërore në Prishtinë (dhe në rrethinë të saj), si dhe
3. Monumentet e Luftës së Dytë Botërore të ndërtuara nga artistë të njohur jugosllavë (Bogdan Bogdanović dhe Miodrag Živković).

Nëpërmjet këtyre vizitave, mund të shihen gjashtë monumente të Luftës së Dytë Botërore ku përfshihen:

1. Monumenti për Minatorët e Rënë, Mitrovicë Veriore,
2. Varrezat e Martirëve Partizanë, Prishtinë,
3. Monumenti i Boro Vukmirovic-it dhe Ramiz Sadikut, Prishtinë,
4. Monumenti i Heronjëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, Prishtinë,
5. Monumenti në Fushë Kosovë, si dhe
6. Monumenti i Aradhës (Çetës) Partizane të Malit të Sharrit, Brezovicë/Shtërpçë.

Siç vërehet, shumica e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore gjenden në qytetin e Prishtinës (kryeqytetin e Kosovës) dhe në afërsinë e saj (Fushë Kosovë), ndërsa të tjerat janë në Mitrovicën Veriore dhe në Brezovicë. Përveç këtyre monumenteve, ka edhe trashëgimi të tjera kulturore, peizazhe natyrore dhe atraksione të tjera turistike për t'u parë ose përjetuar përgjatë udhëtimit.


Prishtina ofron vende me vlerë të trashëgimisë kulturore (arkeologjike dhe arkitektonike) të shumta brenda qytetit dhe në afërsi të saj, parqe natyrore, si dhe atraksione të tjera urbane (muze, galeri të artit, ngjarje kulturore, kafene, restorante etj.). Qyteti është gjithashtu i njohur për jetën aktive të natës. Disa nga atraksionet turistike në Prishtinë përfshijnë Muzeun Kombëtar të Kosovës, Xhaminë e Çarshisë, rrënojat e Hamamit të Çarshisë, Xhaminë e Jashar Pashës, Sahat Kullën, Xhaminë dhe Hamamin e Sulltan Mehmet Fatihut II, Muzeun Etnografik etj. Në rrethinën e saj mund të shihen edhe lokaliteti arkeologjik Ulpiana dhe Manastiri i Graçanicës.

Atraksionet turistike në zonën e Mitrovicës përfshijnë Kishën e Shën Demetrit (në Mitrovicën Veriore), Urën e Lumit Ibër (që ndan qytetin e Mitrovicës), Liqenin artificial të lumit Ibër (në Mitrovica Jugore), Xhaminë e Zalli, Hamamin e Qytetit të Vjetër, Hotel Jadranin, Kishën Bazilike të Pjetrit dhe Minierën e Trepçës në Stan Tërg (në Mitrovicën Jugore), si dhe Kalanë e Zveçanit dhe Manastirin e Banjskës (në Zveçan).

Atraksionet në Shtërpcë përfshijnë Parkun Nacional “Mali Sharr” (që ofron ecje në natyrë, shëtitje, pamje të shtazëve të egra etj.), Qendrën e skijimit “Brezovica”, liqenin e Jazhincës, kishat e Shën Nikollës dhe Shën Jovanit, shpellat etj. Parku Nacional “Mali Sharr” është një degë e veçantë e Dinarideve që ndodhet në pjesën jug-lindore të Kosovës. Ai paraqet kufi natyror midis Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Parku është një ndër malet më të mëdha (me gjatësi 70 km dhe gjerësi 30 km, gjithsej 534 km) dhe më të larta në Gadishullin e Ballkanit (Park Dinarides, p.d.). Ai ka një natyrë të paprekur dhe bukuri të egër, të mbështetur nga mbi 1500 lloje të bimëve, 200 specie zogjsh, 147 lloje fluturash etj. (Park Dinarides, p.d.). Zona gjithashtu karakterizohet me trashëgiminë kulturore, etnografinë (stilet e veshjeve shumëngjyrëshe), muzikën dhe traditat popullore. Në afërsi, ekziston edhe një monument tjetër i Luftës së Dytë Botërore (i referuar si Monumenti i Putnicës) i ndërtuar në fshatin Rakanoc, i cili më parë ishte pjesë e Komunës së Ferizajt dhe tani e Komunës së Shtërpcës. Ky monument u ndërtua diku rreth viteve të 1950-ta për të përkujtuar ekzekutimin e 46 banorëve vendorë serbë të vrarë nga forcat bullgare më 28 qershor 1944 (Spomenik Database, p.d., Traces of War, p.d.).

Rruga 1 – Monumentet e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë

Kjo rrugë e propozuar ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të monumenteve të Luftës së Dytë Botërore në Kosovë. Ajo mund të fillojë nga Mitrovica Veriore drejt Brezovicës/Shtërpcë duke kaluar nëpër Prishtinë, ose anasjelltas, varësisht nga pika më e afërt e hyrjes në Kosovë. Rruga kalon përgjatë pjesës lindore të Kosovës duke e përshkuar shtetin nga veriu në jug. E gjithë vizita mund të organizohet brenda ditës.



Vendndodhja e monumenteve në Mitrovicë, Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Shtërpcë.

Më poshtë janë paraqitur monumentet e Luftës së Dytë Botërore, me një përshkrim të shkurtër dhe një fotografi, të cilat mund të shihen përgjatë kësaj rruge.


Rruga 1 – Monumentet e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë			
#	Monumentet e LB II	Përshkrimi	Fotografia
1.	Monumenti për Minatorët e Rënë, Mitrovicë Veriore	Përkujton revoltën e minatorëve vendorë shqiptarë dhe serbë (Çeta e Minatorëve) kundër forcave gjermane. Arkitekturë brutaliste, përfaqëson koritën e minierave, pikë referimi në qytet.	
2.	Varrezat e Dëshmorëve Partizanë, Prishtinë	Përfaqëson luftëtarë dhe civilë nga zona që u zhdukën gjatë luftës. Kompleks në formë të yllit/lules nga konstruksioni i betonit të armuar, me sferë të kuqe qendrore, pikë referimi në qytet.	
3.	Monumenti i Boro Vukmirović-it dhe Ramiz Sadikut, Prishtinë	Përkujton miqësinë e dy partizanëve/ushtarëve antifashistë, Boros dhe Ramizit, një simbol i vëllazërisë dhe bashkimit. Shkallë njerëzore, bust realist nga bronzi.	
4.	Monumenti i Heronjve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, Prishtinë	Përfaqëson të gjithë (shqiptarë, serbë dhe malazezë) luftëtarët e rënë dhe viktimat e luftës. Monumenti i parë modernist, vepër e madhe prej betoni të armuar, formë elegante, skulptura abstrakte nga bronzi, pikë referimi në qytet.	
5.	Monumenti në Fushë Kosovë	Asnjë informatë nuk është gjetur në internet apo nga autoritetet. Monument i lartë nga betoni i armuar (me një hapje në formë të yllit/vrimës së plumbit), skulptura nga bronzi (me figura në formë të grave, një veçori unike në krahasim me monumentet e tjera).	
6.	Monumenti i Aradhës Partizane të Malit të Sharrit, Brezovicë/Shtërpcë	Përkujton luftëtarët e Aradhës Partizane të Malit të Sharrit. Mure nga betoni i armuar të lakuara që përfaqësojnë mushkëritë, skulpturë abstrakte nga çeliku i zi.	

Rruga 2 – Monumentet e Luftës së Dytë Botërore në Prishtinë (dhe në rrethinë të saj)

Kjo rrugë e sugjeruar ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të monumenteve të Luftës së Dytë Botërore të vendosura në Prishtinë dhe në rrethinën e saj (në Fushë Kosovë). Udhëtimi mund të bëhet brenda gjysmë dite, në këmbë (nëse vizitohen vetëm monumentet brenda qytetit) ose me makinë/transport publik (nëse përfshihet edhe monumenti në Fushë Kosovë).



Afërsia e monumenteve në qytetin e Prishtinës, nëse vizitohen në këmbë.



Afërsia e monumenteve në Prishtinë dhe Fushë Kosovë, nëse vizitohen me makinë ose me transport publik.


Më poshtë janë paraqitur monumentet e Luftës së Dytë Botërore, me një përshkrim të shkurtër dhe një fotografi, të cilat mund të shihen përgjatë kësaj rruge.

Rruga 2 - Monumentet e Luftës së Dytë Botërore në Prishtinë (dhe në rrethinë të saj)

#	Monumentet e LB II	Përshkrimi	Fotografia
1.	Varrezat e Dëshmorëve Partizanë, Prishtinë	Përfaqëson luftëtarë dhe civilë nga zona që u zhdukën gjatë luftës. Kompleks në formë të yllit/lules nga konstruksioni i betonit të armuar, me sferë të kuqe qendrore, pikë referimi në qytet.	
2.	Monumenti i Boro Vukmirović-it dhe Ramiz Sadikut, Prishtinë	Përkujton miqësinë e dy partizanëve/ushtarëve antifashistë, Boros dhe Ramizit, një simbol i vëllazërisë dhe bashkimit. Shkallë njerëzore, bust realist nga bronzi.	
3.	Monumenti i Heronjve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, Prishtinë	Përfaqëson të gjithë (shqiptarë, serbë dhe malazezë) luftëtarët e rënë dhe viktimat e luftës. Monumenti i parë modernist, vepër e madhe prej betoni të armuar, formë elegante, skulptura abstrakte nga bronzi, pikë referimi në qytet.	
4.	Monumenti në Fushë Kosovë	Asnjë informatë nuk është gjetur në internet apo nga autoritetet. Monument i lartë nga betoni i armuar (me një hapje në formë të yllit/vrimës së plumbit), skulptura nga bronzi (me figura në formë të grave, një veçori unike në krahasim me monumentet e tjera).	



Rruga 3 – Monumentet e Luftës së Dytë Botërore të ndërtuara nga artistë të njohur jugosllavë (Bogdan Bogdanović dhe Miodrag Živković)


Kjo rrugë ka për qëllim të promovojë monumente të Luftës së Dytë Botërore të projektuara nga artistë të njohur jugosllavë, siç janë Bogdan Bogdanović dhe Miodrag Živković. Bogdan Bogdanović ka dizajnuar Monumentin për Minatorët e Rënë në Mitrovicën Veriore. Ndërsa, Miodrag Živković ka dizajnuar Monumentin e Heronjëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Prishtinë dhe Monumentin në Fushë Kosovë. Ky udhëtim mund të kompletohet brenda një gjysmë dite.



Vendndodhja e monumenteve në Mitrovicë, Prishtinë dhe Fushë Kosovë.

Më poshtë janë paraqitur monumentet e Luftës së Dytë Botërore që mund të shihen gjatë kësaj rruge.

Rruga 3 – Monumentet e Luftës së Dytë Botërore të ndërtuara nga artistë të njohur jugosllavë			
#	Monumentet e LB II	Përshkrimi	Fotografia
1.	Monumenti për Minatorët e Rënë, Mitrovicë Veriore	Përkuajton revoltën e minatorëve vendorë shqiptarë dhe serbë (Çeta e Minatorëve) kundër forcave gjermane. Arkitekturë brutaliste, përfaqëson koritën e minierave, pikë referimi në qytet.	
2.	Monumenti i Heronjëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, Prishtinë	Përfaqëson të gjithë (shqiptarë, serbë dhe malazezë) luftëtarët e rënë dhe viktimat e luftës. Monumenti i parë modernist, vepër e madhe nga betoni i	

		armuar, formë elegante, skulptura abstrakte nga bronzi, pikë referimi në qytet.	
3.	Monumenti në Fushë Kosovë	Asnjë informatë nuk është gjetur në internet apo nga autoritetet. Monument i lartë nga betoni i armuar (me një hapje në formë të yllit/vrimës së plumbit), skulptura nga bronzi (me figura në formë të grave, një veçori unike në krahasim me monumentet e tjera).	

Shembujt e analizës së detajuar të monumenteve të përzgjedhura

Nga dhjetë (10) monumente të përfshira në një listë të gjerë të monumenteve në Kosovë, janë përzgjedhur gjashtë (6), për të cilat janë bërë analiza të hollësishme të bazuara në një pyetësor të përgatitur paraprakisht. Analiza të hollësishme janë bërë për monumentet në vijim:

1. **Monumenti për Minatorët e Rënë APO Tempulli i Revolucionit**, Kodra e Minatorëve, Mitrovicë Veriore; autor: Bogdan Bogdanoviq
2. **Varrezat e Martirëve Partizanë**, Kodra e Matçanit në lagjen Velanija, Prishtinë; autor: Svetislav Liqina
3. **Monumenti për Heronjë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare APO Monumenti i Revolucionit**, Sheshi Adem Jashari (ish-Sheshi Vëllazërim Bashkim), Prishtinë; autor: Miodrag Zhivkoviç
4. **Monumenti për Aradhën Partizane të Malit të Sharrit**, Brezovicë, Shtërpçë; autor: Svetomir Arsiq Basara
5. **Monumenti i Boro Vukmiroviçit dhe Ramiz Sadikut**, Parki i Qytetit, Prishtinë; autor: I panjohur
6. **I panjohur**, Sheshi i Lirisë, Fushë Kosovë; autor: M(iodrag) Zhivkoviç

Në këtë dokument janë prezantuar dy prej gjashtë monumenteve të trajtuara në detaje:

- **Monumenti për Heronjë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare APO Monumenti i Revolucionit**, Sheshi Adem Jashari (ish-Sheshi Vëllazërim Bashkim), Prishtinë; autor: Miodrag Zhivkoviç
- **Monumenti për Minatorët e Rënë APO Tempulli i Revolucionit**, Kodra e Minatorëve, Mitrovicë Veriore; autor: Bogdan Bogdanoviq

Analizat e detajuara të monumenteve të tjera të përzgjedhura i janë dorëzuar RCC-së.

Monumenti për Heronjtë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare



Monumenti për Heronjtë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Burimi: Marko Krojac, 2012.

TË DHËNAT THEMELORE PËR MONUMENTIN

Ky monument i është dedikuar luftëtarëve të rënë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, të cilët luftuan kundër pushtimit fashist gjatë Luftës së Dytë Botërore (Mari, 2015). Ai përbëhet nga dy pjesë: një obelisk prej 22 metrash të gjatë nga betoni i armuar (me tri pole) dhe një skulpturë prej bronzi që përfaqëson tetë figura partizane (Burmund & Pfeifer, 2010, fq. 46). I njohur si Memoriali i Vëllazërim Bashkimit, monumenti synon të simbolizojë "vëllazërinë dhe bashkimin midis shqiptarëve, serbëve dhe kombësive të tjera" (Burmund & Pfeifer, 2010, fq. 46), kryesisht duke iu referuar malazezëve. Ideja unifikuese e skulpturës është që të përkujtojë luftëtarët e rënë dhe viktimat e luftës (Spomenik Database, p.d.).

Emri zyrtar dhe / apo i zakonshëm i monumentit

Monumenti për Heronjtë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare (Burmund & Pfeifer, 2010, fq. 46). Në gjuhën e përditshme, përmendet si Memoriali i Vëllazërim Bashkimit (Burmund & Pfeifer, 2010, fq.46), "tre rremëshi" (tri degët), dhe "trekëndëshi" (Mari, 2015). Gjithashtu njihet si Monumenti i Revolucionit (Mari, 2015).

Emri dhe mbiemri i projektuesit / dizajnerit

Sheshi dhe monumentet në të janë dizajnuar nga Miodrag Živković.

Dimensionet themelore të monumentit (gjerësia, gjatësia, lartësia)

Lartësia e obeliskut është 22 metra (Burmund & Pfeifer, 2010, fq. 46), ndërsa dimensionet e figurave prej bronzi janë të panjohura. Sheshi ka 160 metra katrorë.

Përshkrimi i karakteristikave vizuale të monumentit / kompleksit memorial

Monumenti përbëhet nga dy pjesë të ndara: një obelisk i bardhë i lartë 22 metra dhe një skulpturë bronzi. Obelisku ka një strukturë elegante, me tri shtylla që hapen si një buqetë në krye, të ndërtuara nga betoni i armuar. Ndërsa, skulptura e bronzit përmban tetë figura (me trupa kubistë këndorë dhe koka të vogla me tipare minimale), të cilat përfaqësojnë tetë luftëtarë partizanë (Burmund & Pfeifer, 2010, fq. 46). Monumentet janë të vendosura në një distancë prej 10 metrash nga njëri-tjetri.

Komente shtesë

i. Lokacioni ku u ndërtua Sheshi Vëllazërim Bashkim dikur ishte Çarshia e Vjetër e Prishtinës, bërthama ekonomike, sociale dhe kulturore e qytetit (Caka, 2016, fq. 16). Çarshia kishte rreth 365 dyqane në fillim të Luftës së Dytë Botërore (Caka, 2016, fq. 17). Ajo u shkatërrua me moton "Rrënojmë të vjetrën, ndërtojmë të renë", me rastin e miratimit të planit të parë urbanistik të Prishtinës në vitet e 1950-ta me qëllim të modernizimit të qytetit (CHwB Kosovo, 2008, fq. 8; Caka, 2016, fq. 17). Rrënimi i Çarshisë krijoi hapësirë për ndërtimin e ndërtesave administrative (Komuna e Prishtinës dhe Ndërtesa e Kuvendit) dhe të Sheshit Vëllazërim Bashkim ndërmjet tyre. Megjithatë, me shkatërrimin e dyqaneve dhe monumenteve të vjetra të arkitekturës tradicionale/vernakulare në Çarshi, të ndikuar nga arkitektura otomane, Prishtina humbi pjesën më të madhe të trashëgimisë kulturore.

ii. Shkallët në hyrje të sheshit nga ana e rrugës Agim Ramadani janë projektuar nga Burhanedin Sokoli (1951 - 2014), arkitekt dhe profesor në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës. Në ligjeratat e tij, ai e merrte sheshin si një shembull "si të mos dizajnohen shkallët, pasi që ato janë shumë të gjata për të bërë një hap të plotë dhe shumë të shkurtëra për të përfshirë një hap të dytë" (Mari, 2015). Sokoli ishte i njohur në Kosovë dhe, si homazh ndaj tij, Komuna e Prishtinës vendosi të mbajë stilin e shkallëve gjatë rinovimit të sheshit.

VENDNDODHJA E MONUMENTIT

Shteti

Kosovë

Komuna


Komuna e Prishtinës

Qyteti

Prishtinë

Informata gjeografike (gjerësia dhe gjatësia)

42°39'56.6"N 21°09'52.4"E

**NDËRTIMI I MONUMENTIT****Data kur filloi ndërtimi i monumentit**

Monumenti është rezultat i një konkursi kombëtar të mbajtur në Jugosllavi në vitin 1959 (Mari, 2015). Ndërtimi filloi në të njëjtin vit (Spomenik Database, p.d.).

Data kur përfundoi ndërtimi i monumentit

1961 (Burmund & Pfeifer, 2010, pg. 46).

Cilës ngjarje historike /person(ave) i dedikohet ky monument? Ju lutemi jepni informata bazë për ngjarjen / person (at).

Revolta e Lëvizjes Partizane Vendore gjatë 1941-1944.

A ka informacion pse monumenti u ndërtua në kohën e caktuar (për shembull, për të shënuar një përvjetor apo ndonjë rast tjetër)?

Nuk u gjet asnjë informacion.

GJENDJA AKTUALE, MËNYRAT E PËRDORIMIT DHE INTERPRETIMI I MONUMENTIT

GJENDJA AKTUALE

Si është gjendja fizike aktuale e monumentit

Në vitin 2010, monumentet u konsideruan "të shkatërruara" dhe të pa trajtuara (Burmund & Pfeifer, 2010, fq. 46). Sot, monumentet janë në një formë të mirë fizike, megjithatë, autenticiteti i tyre është zvogëluar.

A i është nënshtruar monumenti ndonjë ndërhyrjeje, ndryshimi, shtese, etj? Nëse po, ju lutemi përshkruani ato dhe tregoni nëse ato, sipas mendimit tuaj, kanë kontribuar ose kanë degraduar vlerën e tij.

Pas luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, pati një përpjekje për të dëmtuar obeliskun me një dinamit (Burmund & Pfeifer, 2010, fq. 46; Mari, 2015); megjithatë, përpjekja dështoi, dhe të dy monumentet ende qëndrojnë. Pas shpalljes së pavarësisë në Kosovë në vitin 2008, një grup studentësh i ngjyrosën figurat e bronzta me flamuj të vendeve të para që njohën pavarësinë e Kosovës, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, Francën, Gjermaninë, Italinë, Zvicrën, Belgjikën, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shqipërinë. Disa grafite u shtuan në pjesën e poshtme të obeliskut, megjithatë ato janë mbuluar me ngjyrë të bardhë gjatë një ndërhyrjeje të fundit në shesh.

Sheshi Vëllazërim Bashkim u riemërtua në Sheshin Adem Jashari (dikur në vitin 2000 ose 2001, megjithatë nuk ka ndonjë dokument për ta vërtetuar këtë), në emër të një heroi kombëtar të luftës së fundit të Kosovës. Emri u rimiratua zyrtarisht në vitin 2010 (Mari, 2015). Administrata e mëparshme lokale në Prishtinë (në vitin 2010) ka pasur plan nga për të rindërtuar këtë shesh. Plani përfshinte ndërtimin e një garazhe për parkim nëntokësor dhe zëvendësimin e monumenteve të Luftës së Dytë Botërore me monumentin e Adem Jasharit (Mari, 2015). Kjo ide kishte edhe mbështetës dhe kundërshtarë (këta të fundit ishin kryesisht arkitektë dhe artistë), megjithatë, nuk arriti të realizohet. Në vitin 2015, administrata aktuale lokale vendosi të rindërtojë sheshin duke i mbajtur monumentet ashtu siç janë. Deri më sot, monumentet ende qëndrojnë. Sheshi nuk përfaqëson një hapësirë publike socialiste siç ishte dikur.

PËRDORIMI

Në çfarë mënyra është përdorur monumenti që kur është ndërtuar? Çfarë lloj aktiviteteesh u zhvilluan brenda kompleksit të monumentit dhe cilat palë të interesuara i organizuan ato?

Monumentet ndodhen në një shesh publik në qendër të qytetit, i njohur më parë si Sheshi Vëllazërim Bashkim. Sheshi ishte një shesh tipik socialist, me monumentet e vendosura në qendër të tij, një fontanë pranë tyre (e cili nuk ekziston më për shkak të modifikimeve në vitet 1970) dhe pa vende për t'u ulur. Ai ishte përdorur kryesisht për tubime shoqërore

ose politike të organizuara nga shteti (i Jugosllavisë). Pas luftës në Kosovë, sheshi u përdor si skate-park për fëmijë, i cili ishte vendosur në një nga krahët e tij (Mari, 2015).

Cilat janë aktivitetet dominuese të ditëve të sotme të ndërlidhura me monumentin? (Ju lutemi specifikoni llojet e aktiviteteve dhe palët e interesuara që i kryejnë ato - ekskursione, vizita turistike, përkujtime të përvjetorit të tij ose disa tubime / ngjarje të tjera etj.).

Sheshi aktual (tani i njohur si Adem Jashari) përdoret si një hapësirë publike. Pas ndërhyrjeve të fundit nga Komuna e Prishtinës, gjendja e sheshit është përmirësuar. Ka më shumë hapësira të gjelbra dhe vende për t'u ulur rreth monumenteve, si dhe dyshemeja është zëvendësuar tërësisht.

Nuk ka aktivitete përkujtimore apo veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me monumentet apo përfaqësimin e tyre. Sidoqoftë, sheshi është përdorur për tubime dhe ngjarje të tjera artistike (si panaire, ekspozita, botime librash etj.).

INTERPRETIMI DHE PRESENTIMI I MONUMENTIT

A ka ndonjë material edukativ dhe promovues për monumentin (të shtypura dhe digjitale) - broshura, suvenire, filma, video spote, reklama etj? A është përdorur monumenti si skenografi për ndonjë ngjarje? Ju lutemi specifikoni çfarë materiale, kush i krijon ato dhe në çfarë mënyre e përfaqësojnë ato monumentin.

Nuk ka materiale promovuese apo edukative zyrtare rreth monumenteve të përgatitura nga shteti i Kosovës apo administrata lokale e Prishtinës.

Megjithatë, janë disa OJQ që kanë kryer ndërhyrje artistike ose kanë organizuar ngjarje të tjera në shesh. Për shembull, artisti Albert Heta nga Stacion - Qendra për Art Bashkëkohor Prishtina ka zëvendësuar llambat e vjetra ndriçuese në shesh gjatë instalacionit të tij "Revelution (Zbulimi i Revolucionit)" në vitin 2012 (Luci, 2014, fq. 222). Kosovo 2.0, një organizatë e pavarur mediatike, ka shkruar për monumentet dhe gjendjen e tyre në disa artikuj dhe ka organizuar një ngjarje në shesh me rastin e botimit të revistës së tyre Hapësira Publike (diku rreth 2013-2014).

Një organizatë që punon për të ndihmuar tejkalimin e luftës dhe dhunës, si dhe ndërtimit të paqes, *forumZFD* në Kosovë, në mesin e disa ateleve të saj për vendet e kujtesës dhe proceset e përkujtimit (Memory Mapping Kosovo), ka organizuar disa vizita për grupe vendore dhe ndërkombëtare duke shpjeguar historinë dhe kontekstin e monumenteve (*forumZFD Kosovo*, 2014). Vizitat u organizuan për qëllime studimore ose ndërkulturore, prandaj nuk ofrohen si pako zyrtare apo turistike.

Si e paraqesin monumentin tabelat e informacionit, hartat zyrtare dhe infografikat që ndodhen aty? Cilat janë të dhënat dhe tregimet kyçe që ato paraqesin?

Në lokacion nuk ka ndonjë informacion rreth monumenteve.

MJEDISI NATYROR

A ndodhet monumenti në ose afër ndonjë zone natyrore të mbrojtur (park kombëtar etj.). Nëse po, ju lutem specifikoni se në cilën.

Monumentet gjenden në qendër të qytetit, në afërsi të zonës historike të Prishtinës. Përskaj sheshit gjenden disa monumente të trashëgimisë arkitekturore. Për më tepër, në hyrje të tij janë edhe rrënojat e një hamami të shekullit të 15-të.

Nuk ka parqe kombëtare në afërsi, por parqet lokale si Parku i Prishtinës, Taukbashçe dhe Gërmia nuk janë aq larg nga sheshi.

Cilat janë tiparet dhe vlerat specifike të mjedisit natyror / peizazhit përreth monumentit?

Sheshi është i rrethuar nga disa drunjë të vjetër, por ata nuk janë të mbrojtur zyrtarisht.

DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

A është i njohur kompleksi në dokumentet strategjike kombëtare ose lokale (ato që lidhen me zhvillimin, turizmin, planet e biznesit, etj.)? Nëse po, ju lutemi specifikoni se në cilën mënyrë.

Ky shesh është përfshirë në dokumentet e mëparshme të planifikimit hapësinor të Prishtinës, si Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës për periudhën 2012-2022 dhe Plani Rregullues Urban Qendra 1 (2005) si një shesh publik. Të dy planet janë të vjetëruara për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit të ri Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor në vitin 2013. Sheshi nuk ka status të posaçëm mbrojtjeje.

KORNIZA INSTITUCIONALE: STATUSI I MBROJTJES, MENAXHIMI DHE FINANCIMI

STATUSI I MBROJTJES

A ka monumenti ndonjë status mbrojtjeje? Nëse po, ju lutem specifikoni atë.

Monumenti nuk ka status të mbrojtjes.

Nëse monumenti është i mbrojtur, ju lutem tregoni nga cili vit është mbrojtur.

Nuk aplikohet.

Cili institucion është përgjegjës për mbrojtjen e tij?

Duhet të jetë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet e saj përkatëse (Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prishtinë).

MENAXHIMI DHE FINANÇIMI

Cili institucion është përgjegjës për menaxhimin e monumentit apo të kompleksit?

Komuna e Prishtinës.

A ekziston një plan menaxhimi për monumentin? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin bazë (periudhën e vlefshmërisë etj.).

Nuk është gjetur ndonjë informacion rreth planit të menaxhimit të monumentit.

A ka raporte monitorimi lidhur me mbrojtjen apo menaxhimin e monumentit? Nëse po, ju lutemi tregoni se kush i përgatit ato, kujt i dorëzohen dhe për çfarë periudhe kohore përgatiten ato?

Nuk është gjetur ndonjë informacion në burimet e shqyrtuara.

A ka institucioni përgjegjës për menaxhimin ose kujdesin e monumentit buxhet të caktuar për mbrojtjen apo menaxhimin e tij? Nëse po, cila është shuma e buxhetit?

Nuk është gjetur ndonjë informacion për ekzistimin e ndonjë fondi të veçantë për menaxhimin e monumenteve.

A ka ndonjë plan për të bërë investime shtesë në monument apo zonën përreth tij në të ardhmen?

Nuk është gjetur ndonjë informacion në burimet e shqyrtuara.

A ka ndonjë informatë rreth shpenzimeve aktuale për mirëmbajtje, mbrojtje apo restaurim të monumentit?

Nuk është gjetur ndonjë informacion në burimet e shqyrtuara.

A ka ndonjë informatë rreth shumës së të ardhurave totale që rrjedhin nga përdorimi i monumentit (përfshirë donacionet etj.)?

Nuk është gjetur ndonjë informacion në burimet e shqyrtuara.

VIZITAT, OFERTAT DHE PERCEPTIMET TURISTIKE

A ka informacion rreth numrit vjetor të vizitorëve në kompleks? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin dhe burimet e informacionit.

Nuk ka informata për numrin vjetor të vizitorëve në kompleks (vendndodhje të monumentit).

A ka informacion rreth strukturës së vizitorëve? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin dhe burimet e informacionit.

Nuk ka informata rreth strukturës së vizitorëve në kompleks.

A është hyrja në kompleks me pagesë? Nëse po, ju lutemi tregoni se sa?

Qasja në kompleks është pa pagesë. Lokacioni është i hapur për publikun në çdo kohë, pasi është një hapësirë publike.

A ka sezoni turistik aktual ndonjë karakter të veçantë sezonal? Nëse po, ju lutem specifikoni se cilat periudha i mbulon.

Në përgjithësi sezoni turistik në Prishtinë ndikohet kryesisht nga kushtet e motit, pra, kryesisht duke filluar nga muaji mars/prill deri në shtator/tetor. Vetë kompleksi nuk nxit ndonjë ndryshim specifik në sezonin turistik. Meqë nuk ka informata rreth monumenteve në vend, turistët që kalojnë sheshin i vrojtojnë ato me kureshtje (përveç nëse ata veçse kanë ndonjë informatë rreth monumenteve ose janë të shoqëruar me dikë të njoftuar me historinë e tyre).

A ka atraksione turistike në rrethinë (trashëgimi të prekshme dhe / ose të paprekshme)? Nëse po, ju lutemi tregoni se cilat.

Në afërsi ka shumë atraksione turistike, duke përfshirë trashëgimi arkitekturore dhe trashëgimi tjetër të prekshme (brenda muzeve pranë). Disa prej tyre përfshijnë: Muzeun Kombëtar të Kosovës, Xhaminë e Çarshisë, rrënojat e Hamamit të Çarshisë, Xhaminë e Jashar Pashës, Sahatkullën, Xhaminë dhe Hamamin e Sulltanit Mehmet Fatih II, Muzeun Etnologjik etj. Sheshi është gjithashtu në afërsi të qendrës së qytetit, e cila ka edhe atraksione të tjera turistike, siç janë sheshi kryesor i qytetit (Bulevardi Nëna Terezë) i rrethuar me ndërtesa Moderniste, përfshirë Teatrin Kombëtar, burime uji (fontana), monumente të tjera kombëtare, dyqane, kafene dhe restorante.

A ekziston aktualisht ndonjë ofertë turistike e përcaktuar për monumentin e përmendur? Nëse po, ju lutemi përshkruani atë duke specifikuar se çfarë përfshin, kush e siguron atë, për cilat grupe të synuara dedikohet dhe jepni një vegëz me informacionet shtesë.

Nuk ka oferta turistike të përcaktuara për monumentet në veçanti. Megjithatë, ekziston një ofertë për disa monumente dhe ndërtesa të ndërtuara gjatë periudhës së Jugosllavisë, e quajtur "Trashëgimia Komuniste në Prishtinë" dhe e organizuar nga Catun. Ajo përfshin monumentet në Sheshin e Vëllazërim Bashkimit, ndërtesën e Rilindjes, Bankën Qendrore, Bibliotekën Kombëtare dhe Pallatin e Rinisë dhe Sporteve (Boro Ramizi). Oferta kushton 29 euro/person, dhe kërkohet një minimum prej 5 personash për grup (Catun, p.d.).

Bazuar në analizën e kryer të platformave online dhe rrjeteve sociale (Foursquare, TripAdvisor, Airbnb, Facebook, Instagram, etj.), cila është përshtypja e vizitorëve ndaj monumentit? (Ju lutemi shënoni fjalët kyçe që i kanë përmendur, komentet kryesore pozitive dhe negative, se si i përdorin hashtag-et etj.).

Nuk u gjet asnjë përshtypje mbresëlënëse lidhur me monumentet në këtë shesh në rrjetet sociale.



Sipas mendimit tuaj, cili lloj i turizmit do të ishte optimal për këtë monument? Ju lutemi përshkruani shkurtimisht.

Monumentet në shesh kanë vlera historike dhe artistike. Ato janë dëshmi për modernizmin kosovar (Sahatciu, 2013). Ato ishin pika referimi për Prishtinën gjatë periudhës së Jugosllavisë, me ç'rast u shfaqën në shumë kartolina. Sheshi është një përfaqësim i historisë së zhvillimit të Prishtinës si qytet, pozitës së Kosovës në Jugosllavi dhe ideologjisë së Titos për Vëllazërim Bashkimit. Prandaj, ai dhe monumentet në të duhet të përfaqësohen ashtu siç duhet përmes pakove turistike.

INFRASTRUKTURA E TURIZMIT

A ka vend-parking afër monumentit për vetura private, biçikleta dhe autobusë? Ju lutemi përshkruani atë. Ju lutemi tregoni distancën e tij nga kompleksi.

Vetë lokacioni nuk ka hapësira parkimi, megjithatë, ka një parking privat afër tij (në distancë prej rreth 2-3 minuta në këmbë) kryesisht për makina. Nuk ka parking të caktuar për autobusë apo biçikleta.



A është qasje në monument e projektuar mirë dhe e sigurt? Ju lutemi përshkruani.

Lokacioni arrihet me lehtësi përmes autobusëve të ndryshëm publikë. Është lehtësisht i qasshëm në këmbë dhe ka pjerrina për karroca. Ka ndriçim të mirë dhe është i sigurt gjatë natës.

A ka qasje për vizitorët me aftësi të kufizuara në monument, p.sh. në të gjitha zonat e qasme për turistët e tjerë? Ju lutemi përshkruani.

Po, sheshi ka pjerrina për karroca.

A ka tualete në kompleks? Ju lutemi tregoni distancën e tyre nga monumenti dhe nëse gjendja e tyre është e kënaqshme ose e pakënaqshme (gjendja fizike, mirëmbajtja...).

Nuk ka tualete në lokacion. Tualetet mund të gjinden në kafenetë dhe restorantet në afërsi.

A është kompleksi i pajisur me mobilar urbane, stola/ulëse, kosha për mbeturina etj. Ju lutemi përshkruani.


Sheshi ka stola/ulëse dhe shporta për mbeturina, të cilat janë shtuar gjatë një ndërhyrjeje të fundit në shesh nga ana e Komunës së Prishtinës.

A është kompleksi i pajisur me infografikë, shenja, mbishkrime etj. në gjuhë të ndryshme? Ju lutemi përshkruani.

Nuk ka infografikë, shenja apo mbishkrime për monumentet në shesh.

A ka ndonjë burim të ujit të pijshëm në kompleks ose në afërsi të tij (ju lutemi shënoni se ku)? Ju lutemi përshkruani nëse ai është burim i natyrshëm i ujit, nëse ndodhet brenda një ndërtese etj.

Sheshi nuk ka ndonjë burim të ujit të pijshëm, por një krua/çezmë gjendet në afërsi prej rreth 2 minuta ecje.



A ka ndriçim në kompleks? Ju lutemi përshkruani.

Po, ka ndriçim në shesh, i cili është vendosur rishtazi.

A ka kompleksi mbulueshmëri nga ndonjë rrjet celular, WI-FI etj.?

Sheshi ka mbulueshmëri të rrjeteve të telefonisë mobile (nga operatorët kryesorë në Kosovë që janë Vala, IPKO dhe Zmobile). Nuk ka Wi-Fi të hapur.

Në çfarë distance nga kompleksi mund të gjendet ndonjë kafene, restorant dhe vend për akomodim?

Kafene dhe restorante mund të gjenden fare pranë sheshit, duke filluar nga ato përballë sheshit në një distancë ecjeje një-minutëshe, përballë ndërtesës së Komunës së Prishtinës, ose në Bulevardin Nënë Terezë (më pak se 5 minuta në këmbë). Hoteli më i afërt është Hoteli Parlament (4 minuta në këmbë), por ka edhe hotele dhe motele të tjera në afërsi (më pak se 10 minuta në këmbë). Shumë apartamente të vendosura në AirBnB mund të gjenden në afërsi gjithashtu.

GRUPET E INTERESIT

1. Shoqata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare
2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
3. Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore
4. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prishtinë
 - a. Komuna e Prishtinës
 - b. Fondacioni Kosovar i Arkitekturës – KAF
 - c. *forumZFD* Kosovo
 - d. Alter Habitus - Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë
 - e. Programi Universitar për Studime dhe Hulumtime Gjinore
 - f. Stacion - Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë
 - g. Trashëgimia Kulturore pa Kufij - CHwB Kosovë
 - h. Kosovo 2.0
 - i. Catun – Adventure in the Balkans

BURIMET

1. Burmund, D. & Pfeifer, Ch. (2014). MONUMENT: The changing face of remembrance. *forumZFD* & CRDP.
2. Caka, F. (2016). Monumentet e socializmit në Prishtinë – Rast studimi ish-sheshi “Vëllazërim-Bashkim”. Punim diplome për titullin Bachelor i Sociologjisë në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”
3. Catun. (p.d.) Communism Heritage in Prishtina. Catun – Adventure in the Balkans. Link: <http://www.catun.net/tours/communism-in-prishtina/>
4. CHwB Kosovo. (2008). Heritage of Prishtina. Report series No. 12/2008.
5. *forumZFD* Kosovo. (2014). *Handbook – Kosovo Memory Walk*. Memory Mapping Kosovo: Contested Memories. Prishtinë: *forumZFD*
6. Luci, N. (2014). Seeking independence: Making nation, memory, and manhood in Kosova. A dissertation submitted in partial fulfilment of the requirements for the degree of Doctor of Philosophy (Anthropology) in the University of Michigan.
7. Mari, Ch. (2015). A monument between Brotherhood and Unity and Adem Jashari. Kosovo 2.0. Link: <https://kosovotwopointzero.com/en/a-monument-between-brotherhood-and-unity-and-adem-jashari/>
8. Sahatciu, V. (2013). Monuments without a home. Kosovo 2.0. Link: <https://kosovotwopointzero.com/en/monuments-without-a-home/>
9. Spomenik Database. (p.d.). Prishtina. Link: <https://www.spomenikdatabase.org/pristina>

SHTOJCAT

Dokumentacioni i Fotografive



*Monumenti për Heronjtë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.
Burimi: Arkivi i Komunës së Prishtinës, 1970-at.*



*Monumenti për Heronjtë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.
Burimi: Fjollë Caka, 2012.*



Monumenti për Heronjtë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Burimi: Marko Krojac, 2012.



Obelisku. Burimi: forumZFD Kosovo, 2014.



Figurat e tetë luftëtarëve partizanë nga bronzi i derdhur. Burimi: Spomenik Database, 1970-at.



Figurat e bronzit të ngjyrosura me flamuj. Burimi: Spomenik Database, p.d.

Biografia e Artistit/Dizajnerit

Miodrag Zhivković ishte një skulptor serb i njohur për memorialet e tij në ish-Jugosllavi. Ai lindi në Leskovac, në Serbinë jugore, në vitin 1928 (Mari, 2015). Në vitet 1970 dhe 1990, ai ishte dekan i Fakultetit të Arteve të Aplikuara në Universitetin e Beogradit.

Monumenti për Minatorët e Rënë, Mitrovicë Veriore

TË DHËNAT THEMELORE PËR MONUMENTIN

Ky monument përkujton minatorët shqiptarë dhe serbë, të cilët iu bashkuan Lëvizjes Nacionalçlirimtare gjatë Luftës së Dytë Botërore (Çeta e Minatorëve) (Burmund & Pfeifer, 2014, fq. 53). Monumenti ndodhet në një kodër në Komunën e Mitrovicës Veriore (gjatë kohës së ndërtimit e quajtur Mitrovica/Kosovska Mitrovica) dhe mund të shihet edhe nga Zveçani. Ai ka qenë një pikë referimi (dominuese) për qytetin e Mitrovicës (i cili tani është i ndarë në Mitrovicën Jugore dhe Mitrovicën Veriore) qysh nga ndërtimi i tij. Monumenti konsiderohet "qendra e lëvizjes së klasës punëtore dhe ideologjisë komuniste në Kosovë" (Burmund & Pfeifer, 2014, fq. 53). Duke marrë parasysh rëndësinë e tij ndaj Jugosllavisë, ky ishte monumenti më i vlefshëm i regjimit komunist në Kosovë (Burmund & Pfeifer, 2014, fq. 53). Kishte për qëllim të "dëshmonte bashkëjetesën paqësore të dy komuniteteve në Jugosllavinë e pasluftës" (Notre Europe, 2008, fq. 3).

Emri zyrtar dhe / apo i zakonshëm i monumentit

Monumenti për Heronjtë Minatorë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare (Burmund & Pfeifer, 2014, fq. 53). Gjithashtu i njohur si Monumenti për Minatorët e Rënë ose Tempulli i Revolucionit (Spomenik Database, p.d.).

Emri dhe mbiemri i projektuesit / dizajnerit

Bogdan Bogdanović.

Dimensionet themelore të monumentit (gjerësia, gjatësia, lartësia)

19 metra i gjatë (Spomenik Database, p.d.).

Përshkrimi i karakteristikave vizuale të monumentit / kompleksit memorial

Monumenti përbëhet nga dy shtylla masive me konike që mbajnë një karrocë të stilizuar (që simbolizon një vagon/koritë që përdorej për transportimin e mineraleve në minierën e Trepçës). Shtyllat dhe vagoni janë ndërtuar nga betoni i armuar (Spomenik Database, p.d.). Vagoni dikur ishte i veshur me fletë bakri, por ato janë hequr (ose janë vjedhur) përgjatë viteve.

Dy shtyllat simbolizojnë minatorët shqiptarë dhe serbë, të cilët punuan dhe luftuan së bashku kundër forcave gjermane. Një interpretim tjetër i karrocës në monument e konsideron atë si një djep, duke iu referuar minierës së Trepçës si djep i industrisë dhe prodhimit, si dhe si zemër e fuqisë Jugosllave (Spomenik Database, p.d.). Në vitet 1980, sllogani "Trepça radi, Beograd se gradi" (Trepça punon, Beogradi krijon APO ndërtohet) e shprehte këtë qëndrim.

Në afërsi të monumentit gjenden edhe dy momumente mbivarrore nga gëlqerja të ndërtuara në vitin 1959. Njëri prej tyre përmban eshtrat e luftëtarëve të minatorëve që humbën jetën gjatë viteve 1941-1945 në zonat e afërta. Monumenti mbivarror tjetër është shkatërruar, por i është kushtuar Muharem Bekteshit, një partizan luftëtar vendor i vrrarë në burg në Tiranë në vitin 1944 (Spomenik Database, p.d.).

Komente shtesë

Pas ndarjes së qytetit të Mitrovicës (në vitin 2013) në Mitrovicën Jugore dhe Mitrovicën Veriore si pasojë e procesit të decentralizimit të Kosovës, monumenti i takoi Komunës së Mitrovicës Veriore, e cila është e banuar me shumicë serbe.

VENDNDODHJA E MONUMENTIT

Shteti

Kosovë

Komuna


Komuna e Mitrovicës Veriore

Qyteti

Mitrovica Veriore (pjesë e qytetit të Mitrovicës/Kosovska Mitrovica që u nda në Mitrovicën Jugore dhe Mitrovicën Veriore në vitin 2013).

Informata gjeografike (gjerësia dhe gjatësia)

42°53'45.3"N 20°51'36.4"E



NDËRTIMI I MONUMENTIT

Data kur filloi ndërtimi i monumentit

Nuk kam gjetur një informacion të tillë në burimet e shqyrtuara.

Data kur përfundoi ndërtimi i monumentit

1973.

Cilës ngjarje historike /person(ave) i dedikohet ky monument? Ju lutemi jepni informata bazë për ngjarjen / person (at).

Revoltimi i minatorëve më 30 korrik 1941 dhe çlirimi i Mitrovicës më 23 nëntor 1944.

A ka informacion pse monumenti u ndërtua në kohën e caktuar (për shembull, për të shënuar një përvjetor apo ndonjë rast tjetër)?

Asnjë informacion nuk është gjendur në burimet e shqyrtuara.

GJENDJA AKTUALE, MËNYRAT E PËRDORIMIT DHE INTERPRETIMI I MONUMENTIT

GJENDJA AKTUALE

Si është gjendja fizike aktuale e monumentit

Gjendja e strukturës fizike të monumentit është e mirë, por fasada nga betoni është eroduar/dëmtuar mjaft. Monumenti nuk mirëmbahet si dhe nuk është nën ndonjë përkujdesje.

A i është nënshtruar monumenti ndonjë ndërhyrjeje, ndryshimi, shtese, etj? Nëse po, ju lutemi përshkruani ato dhe tregoni nëse ato, sipas mendimit tuaj, kanë kontribuar ose kanë degraduar vlerën e tij.

Monumenti nuk i është nënshtruar ndonjë ndërhyrjeje fizike e as shtesave, përveç dëmtimit (heqjes me kalimin e kohës) të fasadës së bakrit. Në bazën e shtyllave konike kanë qenë disa mbishkrime/grafiti, por ato janë mbuluar me ngjyrë të bardhë.

PËRDORIMI

Në çfarë mënyra është përdorur monumenti që kur është ndërtuar? Çfarë lloj aktiviteteesh u zhvilluan brenda kompleksit të monumentit dhe cilat palë të interesuara i organizuan ato?

Memoriali u përdor si një vend për të përkujtuar minatorët ushtarë të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Cilat janë aktivitetet dominuese të ditëve të sotme të ndërlidhura me monumentin? (Ju lutemi specifikoni llojet e aktiviteteve dhe palët e interesuara që i kryejnë ato - ekskursione, vizita turistike, përkujtime të përvjetorit të tij ose disa tubime / ngjarje të tjera etj.).

Nuk ka aktivitete aktuale (përkujtime ose vizita zyrtare) që ndodhin te monumenti.

INTERPRETIMI DHE PRESENTIMI I MONUMENTIT

A ka ndonjë material edukativ dhe promovues për monumentin (të shtypura dhe digjitale) - broshura, suvenire, filma, video spote, reklama etj? A është përdorur monumenti si skenografi për ndonjë ngjarje? Ju lutemi specifikoni çfarë materiale, kush i krijon ato dhe në çfarë mënyre e përfaqësojnë ato monumentin.

Nuk ka materiale promovues ose edukative zyrtare lidhur me monumentin. Një organizatë e cila punon për të ndihmuar në tejkalimin e luftës dhe dhunës, si dhe ndërtimin e paqes, *forumZFD* në Kosovë, në mesin e disa ateleve të saj për vendet e kujtesës dhe proceset e përkujtimit (Memory Mapping Kosovo), ka organizuar disa vizita për grupe vendore dhe ndërkombëtare duke shpjeguar historinë dhe kontekstin e monumenteve (*forumZFD* Kosovë, 2014). Vizitat u organizuan për qëllime studimore ose ndërkulturore, prandaj nuk ofrohen si pako zyrtare apo turistike.

Si e paraqesin monumentin tabelat e informacionit, hartat zyrtare dhe infografikat që ndodhen aty? Cilat janë të dhënat dhe tregimet kyçe që ato paraqesin?

Në lokacion nuk ka ndonjë informacion rreth monumenteve.

MJEDISI NATYROR

A ndodhet monumenti në ose afër ndonjë zone natyrore të mbrojtur (park kombëtar etj.). Nëse po, ju lutem specifikoni se në cilën.

Jo, nuk ndodhet.

Cilat janë tiparet dhe vlerat specifike të mjedisit natyror / peizazhit përreth monumentit?

Monumenti ndodhet në një kodër, e cila ofron pamje panoramike të qytetit të Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës Veriore. Ai gjithashtu mund të shihet nga pothuajse e gjithë zona urbane e të dy komunave.

DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

A është i njohur kompleksi në dokumentet strategjike kombëtare ose lokale (ato që lidhen me zhvillimin, turizmin, planet e biznesit, etj.)? Nëse po, ju lutemi specifikoni se në cilën mënyrë.

Mitrovica e Veriut është themeluar në vitin 2013 në sajë të procesit të decentralizimit në Kosovë. Si komunë e re, ajo së fundi ka filluar hartimin e Planit Zhvillimor Komunal bazuar në Ligjin e ri për Planifikimin Hapësinor në Kosovë, i cili ende nuk është përfunduar. Lokacioni i monumentit është trajtuar si hapësirë publike në Planin Zhvillimor Komunal dhe atë Urban të mëparshëm (hartuar në vitin 2009), kur qyteti i Mitrovicës nuk ishte i ndarë në dy komuna (Mitrovica Jugore dhe Mitrovica Veriore). Monumenti nuk u trajtua veçanërisht.

KORNIZA INSTITUCIONALE: STATUSI I MBROJTJES, MENAXHIMI DHE FINANCIMI

STATUSI I MBROJTJES

A ka monumenti ndonjë status mbrojtjeje? Nëse po, ju lutem specifikoni atë.

Monumenti nuk ka status të mbrojtjes.

Nëse monumenti është i mbrojtur, ju lutem tregoni nga cili vit është mbrojtur.

Nuk aplikohet.

Cili institucion është përgjegjës për mbrojtjen e tij?

Duhet të jetë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe institucionet e saj përkatëse (Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Mitrovicë).

MENAXHIMI DHE FINANCIMI

Cili institucion është përgjegjës për menaxhimin e monumentit apo të kompleksit?

Komuna e Mitrovicës Veriore.

A ekziston një plan menaxhimi për monumentin? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin bazë (periudhën e vlefshmërisë etj.).

Nuk është gjetur informacion në burimet e shqyrtuara.

A ka raporte monitorimi lidhur me mbrojtjen apo menaxhimin e monumentit? Nëse po, ju lutemi tregoni se kush i përgatit ato, kujt i dorëzohen dhe për çfarë periudhe kohore përgatiten ato?

Nuk është gjetur informacion në burimet e shqyrtuara.

A ka institucioni përgjegjës për menaxhimin ose kujdesin e monumentit buxhet të caktuar për mbrojtjen apo menaxhimin e tij? Nëse po, cila është shuma e buxhetit?

Nuk është gjetur ndonjë informacion për ekzistimin e ndonjë fondi të veçantë për menaxhimin e monumenteve.

A ka ndonjë plan për të bërë investime shtesë në monument apo zonën përreth tij në të ardhmen?

Nuk është gjetur ndonjë informacion në burimet e shqyrtuara.

A ka ndonjë informatë rreth shpenzimeve aktuale për mirëmbajtje, mbrojtje apo restaurim të monumentit?

Nuk është gjetur ndonjë informacion në burimet e shqyrtuara.

A ka ndonjë informatë rreth shumës së të ardhurave totale që rrjedhin nga përdorimi i monumentit (përfshirë donacionet etj.)?

Nuk është gjetur ndonjë informacion në burimet e shqyrtuara.

VIZITAT, OFERTAT DHE PERCEPTIMET TURISTIKE

A ka informacion rreth numrit vjetor të vizitorëve në kompleks? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin dhe burimet e informacionit.

Nuk ka informata për numrin vjetor të vizitorëve në kompleks (vendndodhje të monumentit).

A ka informacion rreth strukturës së vizitorëve? Nëse po, ju lutemi jepni informacionin dhe burimet e informacionit.

Nuk ka informata rreth strukturës së vizitorëve në kompleks.

A është hyrja në kompleks me pagesë? Nëse po, ju lutemi tregoni se sa?

Qasja në kompleks është pa pagesë. Lokacioni është i hapur për publikun në çdo kohë, pasi është një hapësirë publike.

A ka sezoni turistik aktual ndonjë karakter të veçantë sezonal? Nëse po, ju lutem specifikoni se cilat periudha i mbulon.

Vendi në vetëvete nuk nxit ndonjë ndryshim specifik në sezonin turistik.

A ka atraksione turistike në rrethinë (trashëgimi të prekshme dhe / ose të paprekshme)? Nëse po, ju lutemi tregoni se cilat.

Atraksionet turistike më të afërta me monumentin përfshijnë Kishën e Shën Demetrit (që gjendet në kodër përgjatë rrugës për te monumenti), Ura e lumit Ibër (që ndan e qytetin e Mitrovicës) dhe liqeni artificial i lumit Ibër (Mitrovica Jugore). Ka edhe atraksione të tjera turistike në afërsi, siç janë Xhamia e Zallit, Hamami i Vjetër i Qytetit, Hoteli Jadran, Kisha Bazilike e Shën Pjetrit dhe Miniera e Trepçës në Stan Tërg (në Mitrovicën Jugore), si dhe Kalaja e Zveçanit dhe Manastiri i Banjskës (në Zveçan).

A ekziston aktualisht ndonjë ofertë turistike e përcaktuar për monumentin e përmendur? Nëse po, ju lutemi përshkruani atë duke specifikuar se çfarë përfshin, kush e siguron atë, për cilat grupe të synuara dedikohet dhe jepni një vegëz me informacionet shtesë.

Nuk kam informacion për ndonjë ofertë turistike të përcaktuar për monumentin.

Bazuar në analizën e kryer të platformave online dhe rrjeteve sociale (Foursquare, TripAdvisor, Airbnb, Facebook, Instagram, etj.), cila është përshtypja e vizitorëve ndaj monumentit? (Ju lutemi shënoni fjalët kyçe që i kanë përmendur, komentet kryesore pozitive dhe negative, se si i përdorin hashtag-et etj.).

Në përgjithësi, vizitorët e vlerësojnë dedikimin e monumentit ("sakrificës së minatorëve që luftuan dhe vdiqën për vendin e tyre"), vlerat historike (qyteti minator i Mitrovicës) dhe artistike ("vepër e rëndësishme e periudhës sovjetike e dizajnuar nga Bogdan Bogdanović", si dhe lokacionin (si objekt dominues në horizontin e qytetit të ndarë të Mitrovicës) (TripAdvisor, p.d.).


Sipas mendimit tuaj, cili lloj i turizmit do të ishte optimal për këtë monument? Ju lutemi përshkruani shkurtimisht.

Monumenti ka shërbyer si pikë referimi për qytetin e Mitrovicës (i cili tani është i ndarë në Mitrovicën Jugore dhe Mitrovicën Veriore) qysh nga ndërtimi i tij. Monumenti konsiderohet "qendra e lëvizjes së klasave punëtore dhe ideologjisë komuniste në Kosovë (Burmund & Pfeifer, 2014, fq. 53)." Duke marrë parasysh rëndësinë e minierës së Trepçës (pra Mitrovicës dhe Kosovës) në Jugosllavi, ky monument ishte më i vlefshmi për regjimin komunist në Kosovë (Burmund & Pfeifer, 2014, fq. 53). Përveç vlerave historike dhe sociale, monumenti ka edhe vlera artistike. Ai është monumenti i vetëm i ndërtuar nga Bogdan Bogdanović në Kosovë. Kështu, mendoj se monumenti duhet të përfaqësohet siç duhet përmes pakove turistike.

INFRASTRUKTURA E TURIZMIT

A ka vend-parking afër monumentit për vetura private, biçikleta dhe autobusë? Ju lutemi përshkruani atë. Ju lutemi tregoni distancën e tij nga kompleksi.

Në afërsi të zones gjendet një vend parkimi.



A është qasja në monument e projektuar mirë dhe e sigurt? Ju lutemi përshkruani.

Monumenti gjendet në distancë prej rreth 15 minuta në këmbë nga Ura kryesore e lumit Ibër (i cili ndan Mitrovicën Veriore dhe Mitrovicën Jugore). Ecja nëpër kodër bëhet përmes Rrugës së Shën Dhimitrit. Drejt monumentit janë disa shkallë me kalldrëm/kubëza guri. Vendi nuk ka ndriçim.

A ka qasje për vizitorët me aftësi të kufizuara në monument, p.sh. në të gjitha zonat e qasshme për turistët e tjerë? Ju lutemi përshkruani.

Nuk ka qasje për vizitorët me aftësi të kufizuara (nuk ka pjerrina për karrocë).

A ka tualete në kompleks? Ju lutemi tregoni distancën e tyre nga monumenti dhe nëse gjendja e tyre është e kënaqshme ose e pakënaqshme (gjendja fizike, mirëmbajtja...).

Nuk ka tualete në lokacion.

A është kompleksi i pajisur me mobilar urbane, stola/ulëse, kosha për mbeturina etj. Ju lutemi përshkruani.

Nuk gjendet ndonjë stol/ulëse apo shportë për mbeturina në lokacion.

A është kompleksi i pajisur me infografikë, shenja, mbishkrime etj. në gjuhë të ndryshme? Ju lutemi përshkruani.

Nuk ka infografikë, shenja apo mbishkrime për monumentin e Minatorëve. Informacioni është dhënë vetëm në monumentët mbivarrore, ku janë gdhendur emrat e luftëtarëve dhe një tekst përkushtimi nga Punëtorët Kolektivë të Trepçës.

A ka ndonjë burim të ujit të pijshëm në kompleks ose në afërsi të tij (ju lutemi shënoni se ku)? Ju lutemi përshkruani nëse ai është burim i natyrshëm i ujit, nëse ndodhet brenda një ndërtese etj.

Vendi ku ndodhet monumenti nuk ka ndonjë burim të ujit të pijshëm. Nuk posedoj informata nëse ka ndonjë burim uji në afërsi.

A ka ndriçim në kompleks? Ju lutemi përshkruani.

Nuk ka ndriçim në kompleks.

A ka kompleksi mbulueshmëri nga ndonjë rrjet celular, WI-FI etj.?

Kompleksi ka mbulueshmëri të rrjeteve të telefonisë (së operatorëve kosovarë dhe serbë). Nuk ka Wi-Fi të hapur.

Në çfarë distance nga kompleksi mund të gjendet ndonjë kafene, restorant dhe vend për akomodim?

Kafenetë, restorantet dhe disa hotele (p.sh. Hotel North City ose Hotel BB) mund të gjenden në një distancë prej 10-15 minutash në këmbë poshtë kodrës ose brenda qendrës së qytetit të Mitrovicës Veriore (por edhe në Mitrovicën Jugore)

GRUPET E INTERESIT

- a. Shoqata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare
- b. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- c. Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore
- d. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Mitrovicë
- e. Komuna e Mitrovicës Veriore
- f. OJQ Aktiv
- g. *forumZFD* Kosovo
- h. Alter Habitus - Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë
- i. Programi Universitar për Studime dhe Hulumtime Gjinore
- j. Fondacioni Kosovar i Arkitekturës – KAF
- k. Stacion - Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë
- l. Trashëgimia Kulturore pa Kufij - CHwB Kosovë
- m. Kosovo 2.0

BURIMET

1. Burmund, D. & Pfeifer, Ch. (2014). MONUMENT: The changing face of remembrance. *forumZFD* & CRDP.
2. Spomenik Database. (p.d.). Prishtina. Link: <https://www.spomenikdatabase.org/pristina>
3. Notre Europe. (2008). Interview with Bogdan Bogdanović by Alexandre Mirlesse. Rencontre Européenne Nb. 7. Link: <http://www.helsinki.org.rs/doc/RE7%20-%20BBogdanovic.pdf>
4. TripAdvisor. (p.d.). Miner's Monument. Link: https://www.tripadvisor.com/Attraction_Review-g774868-d12514695-Reviews-Miner_s_Monument-Mitrovica.html#photos;aggregationId=&albumid=101&filter=7&ff=259872729

SHTOJCAT

Dokumentacioni i Fotografive



Monumenti për minatorët e rënë në Mitrovicë. Burimi: Marko Krojac, 2014.



Monumenti i minatorëve (majtas) dhe pllaka me emra. Burimi: forumZFD Kosovo, 2015.

Deklarata mbi mohimin e përgjegjësish: Ky dokument “Vlerësimi i monumenteve të pas-Luftës së Dytë Botërore në Kosovë me qëllim të zhvillimit të një produkti të ri rajonal turistik/rrugë kulturore në Evropën Juglindore” është hartuar me asistencë të grantit të siguruar përmes Projektit për Zhvillim dhe Promovim të Turizmit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, të cilin e financon Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti “Vlerësimi i monumenteve të pas-Luftës së Dytë Botërore në Kosovë me qëllim të zhvillimit të një produkti të ri rajonal turistik/rrugë kulturore në Evropën Juglindore” është përgjegjësi ekskluzive e EXPEDITIO dhe nuk i shpreh doemos qëndrimet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal ose të Bashkimit Evropian.